



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KUÇOVË

Nr.Prot \_\_\_\_\_

Kuçovë, më \_\_\_/\_\_\_/2019

Lënda : Raport i monitorimit të buxhetit për periudhën Janar – Dhjetor 2018.  
Drejtuar: Këshillit Bashkiak Kuçovë

Raporti i monitorimit të Buxhetit është në zbatim të ligjit nr. 9936 dt. 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 22, datë 30. 07. 2018, “ Për Procedurat Standarde të Monitorimit të Buxhetit të Njësive të Qeverisjes Vendore”, të ligjit nr. 9632 datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” të ndryshuar, ligjit nr. 139/2015, dt. 17.12.2015, “ Për Vetëqeverisjen Vendore” si dhe udhëzimit plotësues të zbatimit të Buxhetit të vitit 2018 nr. 2 , dt., 19.01.2018.

**a. Hyrje:**

**Misioni i Bashkisë Kuçovë:** *Bashkia Kuçovë, përtej qëllimit ekonomik, synon të krijojë një mjedis shoqëror të shëndetshëm nga i cili përfiton i gjithë komuniteti, ku e mira e përbashkët mbizotëron; ku banorët jetojnë në harmoni me burimet natyrore, hapësirat publike dhe komunitetet e tjera që e rrethojnë, sot e në vazhdim.*

**Objektivat afatgjata të Bashkisë Kuçovë:**

**Objektivi strategjik 1:** Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik-social, duke diversifikuar ekonominë urbane dhe duke specializuar ekonominë rurale, me synim uljen e papunësisë, frenimin e largimit të fuqisë punëtore, fuqizimin e kontributit dhe konkurrueshmërisë rajonale të Bashkisë Kuçovë në sektorin industrial, bujqësor e turistik, si dhe rritjen e cilësisë së jetesës për banorët.

**Objektivi strategjik 2:** Zhvillimi i infrastrukturës rajonale, për të përmirësuar aksesin në boshtet kryesore të rajonit, dhe në itineraret turistike, si dhe përmirësimi i situatës lokale të mobilitetit, transportit, dhe shërbimeve të lidhur me infrastrukturën.

**Objektivi strategjik 3:** Menaxhim i qëndrueshëm mjedisor, në mbrojtje të sistemit të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore, duke valorizuar tokën bujqësore dhe elementët e forte natyrorë dhe artificialë, në funksion të zhvillimit të turizmit natyror dhe historiko-kulturor dhe integritit me potencialet rajonale turistike.

**Objektivi strategjik 4:** Mbështetja e komuniteteve të qëndrueshme dhe të shëndetshme, me cilësi jetese të përmirësuar, mundësi më të mira zhvillimi në arsim dhe punësim, dhe nivel më të lartë aksesit në aspektin social-kulturor.

Buxheti i Bashkisë Kuçovë për vitin 2018, është miratuar me V.K.B, nr. 70, dt. 22.12.2017, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresë nr. 2080/1 prot., dt. 27.12.2017, (i ndryshuar). Raportet 4- mujore të monitorimit të buxhetit 2018, janë dërguar në Këshillin Bashkiak për informim sipas afateve të përcaktuara në ligj dhe të rakorduara me sistemin e Thesarit. Në Këshillin Bashkiak dërgohen dhe raporte apo informacione të tjera sipas kërkesave të Këshillit. Raportet e monitorimit përgatiten nga çdo njësi shpenzuese për çdo program.

Më poshtë po analizojmë realizimin e të ardhurave të Bashkisë për vitin 2018, duke u ndalur në faktorët kryesorë që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa treguesve dhe në miremenaxhimin e arketimit të Taksave dhe Tarifave vendore për vitin 2018.

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, kreu VIII, neni 34, pika 6, ku citohet: “Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore” ..grupi i punës i ngritur për këtë qëllim hartoi paketën fiskale, e cila u miratua me VKB nr. 56, datë 04.10.2017.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 56 datë 04.10.2017 “Mbi Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore të vitit 2018” Drejtoria e të Ardhurave Vendore mbi bazën e të dhenave të krijuara për çdo grup tatimpaguesish në Njësi dhe në Bashki, hartoi planin e të ardhurave për vitin 2018 për Bashkinë Kuçovë, të detajuar për çdo njësi administrative.

**b. Të ardhurat për vitin 2018** si bashki dhe Njësi Administrative janë realizuar si më poshtë vijon: **ne 000/leke.**

|         | <b>Plani</b> | <b>Fakti</b> | <b>Diferenca</b> | <b>%</b> |
|---------|--------------|--------------|------------------|----------|
| Kuçovë  | 133 664      | 103 232      | 33 051           | 77.2     |
| Kozare  | 8 930        | 8 480        | 450              | 95       |
| Perondi | 15 022       | 11 816       | 3 206            | 79       |
| Lumas   | 5 763        | 5 403        | 360              | 94       |

**Shuma 163 379 128 931 34 448 78.9**

Duke pare pasqyren e mesiperme shohim se te ardhurat e veta jane realizuar ne masen 78.9 % si bashki ndersa njesite administrative e kane realizuar planin: Kozare ne masen 95 %, Perondi 79 % dhe Lumas 94 %, pra nuk jane arketuar rreth 34 448 000 leke ose 21.1% e te ardhurave te planifikuara.

Realizimi i te ardhurave ne masen 78.9 % te planit, dhe pse relativisht nje perqindje e pranueshme, kerkon qe ne te analizojme çdo takse apo tarife sherbimi te miratuar, per çdo grup tatim-paguesish dhe per çdo njesi administrative per te evidentuar arritjet dhe punen e bere si nga Drejtoria e te Ardhurave Vendore po ashtu dhe Drejtorite si Urbanistika, Sherbimet dhe Bujqesia etj, qe ofrojne sherbime te taksueshme e tarifuara, dhe administrojne asetet e bashkise. Njeheresh per te stigmatizuar mosarritjet ne permbushjen e detyrimeve te planifikuara, me qellim reflektimin mbi to dhe marjen e masave per permiresim ne vijim.

I- **Te ardhurat tatimore:**

**1 - Tatim fitimi i thjeshtuar** i biznesit te vogel planifikuar 1000 000 leke realizohet ne shumen 2 230 148 leke pra **223 %** e cila arketohet nga DRTatimeve Berat nga biznesi i vogel, per ata qe kane xhiron nga 5-8 milion leke qe realizojne nje te ardhur neto e cila tathohet me 5 %.

**2 - Tatimi mbi token bujqesore**

Drejtoria e te Ardhurave Vendore bashke me agjentet tatimor ne njesite administrative realizoi brenda dates 20 Prill hartimin dhe shperndarjen e njoftim detyrimit tatimor te tatimit mbi pasurine per tatimin e tokes, tatimin e truallit, si dhe te tarifave te sherbimit te pastrimit e ndricimit per me shume se **6000** tatim pagues ne te tria njesite Kozare, Perondi e Lumas. Kete vite u krijuan dhe u saktesuan regjistrat e tatimpaguesve si per detyrimet e vitit dhe te detyrimeve ne vite ne njesit Perondi dhe Lumas. Te ardhurat nga tatimi i tokes bujqesore realizohet per çdo njesi si me poshte vijon :

ne 000/leke

| Emertimi         | Bashkia | Kozare | Perondi | Lumas |
|------------------|---------|--------|---------|-------|
| Plani i te ardh. | 13 056  | 4 347  | 5 747   | 2 962 |
| Realizimi        | 6 382   | 2 390  | 2 552   | 1 440 |
| Ne %             | 48.9    | 55     | 44.4    | 49    |

Pra siç shihet dhe nga pasqyra e mesiperme kjo e ardhur ne total realizohet 48.9 % . Niveli i ulet i arketimit te kesaj takse, kerkon vemendje dhe reflektim per vitin 2019. Sipas njesive administrative kemi diferencime pra me mire eshte punuar ne njesie Kozare dhe Lumas qe jane me larte se realizimi si bashki dhe me dobet paraqitet ne njesine Perondi. Per te realizuar arketimin e te ardhurave nga toka bujqesore dhe detyrimet e tjera qe jane te lidhura ne nje njoftim detyrimi ne njesite administrative eshte punuar me grupe pune duke bere njoftimin e çdo tatim paguesi nepremjet njoftim detyrimit te leshuar nga inspektoret dhe Administratoret e njesive, ashtu dhe me njoftim zyrtar me Posten Shqiptare, dega Kucove. Ne kushtet e neglizhences ne pagesen e ketyre detyrimeve, jane mare dhe masa penalizuese duke mos ju ofruar sherbimin qe ata kerkonin nga njesia administrative.

**3 – Taksa mbi ndertesën:**

Viti 2018, per shkak te implementimit te ligjit nr.106/2017 date 15.12.2017, "Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr.9632 date 30.10.2006 "Per Taksat Vendore" dhe V.K.M nr.132 date 07.03.2018 "Per Metodologjine per percaktimin e Vleres se Taksueshme te pasurise Ndertesë", solli problem ne menaxhimin dhe arketimin e kesaj takse sidomos per abonentet familjar. Ne fillim te vitit 2018 u hartuan njoftim detyrimet dhe u derguan zyrtarisht nepermjet Postes Shqiptare per çdo subject biznesi , detyrimi per tremujorin e pare me cmimin e "vjeter" ndersa per detyrimin 9-mujor te mbetur, me Vendimin e Keshillit Bashkiak nr. 66 date 22.08.2018, u vendosen cmimet e reja per kategorite e tatim paguesve sipas qellimit te perdorimt te ndertesave. Puna e bere conform V.K.M nr.132, nga Grupet e Verifimit ne teren, beri te mundur nje certifikim te siperfaqeve ndertimore per subjektet e biznesit dhe menjehere u shperndane njoftim detyrimet dhe u kerkua nga punonjesve te kesaj drejtorie arkitimi I kesaj takse nga keto subjekte. Shqetesim dhe problem ka sjelle ndryshimi I cmimit ne mes te vitit ,si per abonentet familjar ashtu dhe per Agjentin Fiskal, qe ishte Posta Shqiptare, per menyren e perlllogaritjes se detyrimit.Gjithashtu conform te ndryshimeve ligjore te cituara, per ndermarjet dhe institucionet me capital shteteror, taksa e nderteses eshte 0 leke.Realizimi i te ardhurave nga taksa e nderteses sipas njesive dhe per çdo grup te taksapaguesve paraqitet si me poshte vijon:

Sipas Njesive ne 000/leke

| Emertimi  | Bashkia | Kuçove | Kozare | Perondi | Lumas |
|-----------|---------|--------|--------|---------|-------|
| Plani     | 12 690  | 7 909  | 1 490  | 2 645   | 646   |
| Fakti     | 5 317   | 3 160  | 837    | 875     | 445   |
| Diference | -7 373  | -4 749 | -653   | -1 770  | -201  |
| Ne %      | 42      | 40     | 56.2   | 33.1    | 69    |

Sipas grupeve te tatimpaguesve ne 000/leke

| Emertimi  | Totali | Nderm/Inst | B.Madh | B.Vogel | Familjaret |
|-----------|--------|------------|--------|---------|------------|
| Plani     | 12 690 | 495        | 1 723  | 6 505   | 3 967      |
| Fakti     | 5 317  | 131        | 512    | 4 129   | 546        |
| Diference | -7 373 | -364       | -1 211 | -2 386  | -3 421     |
| Ne %      | 42     | 27         | 30     | 64      | 14         |

Te ardhurat nga tatimi i ndertesës realizohet **42%** e planit duke krijuar nje debi prej 7 373 000 leke dhe kryesishte nga ndertesë familjare qe ze peshen me te madhe te debise , pastaj biznesi i vogel dhe biznesi i madh te cilet jane paraqitur ne tabel si ne vlera absolute dhe te shprehura ne perqindje.

Treguesit e realizimit te kesaj takse per vitin 2018 jane me te uletit, kjo si pasoje e nderveprimit te faktoreve te cituar me sipër, si dhe per subjektet e biznesit influencon ulja e ndjeshme e cmimit per m2, ne masen relative 62.2% te cmimit te “vjeter”. Nga punonjesit e drejtorise se te Ardhurave eshte ndjekur me prioritet arketimi nga subjektet e biznesit I kesaj takse, duke evidenuar ato pak subjekte, per debine e krijuar nga grupi i tatimpaguesve te biznesit te madh dhe atij te vogel do te ndermeren masat shtrenguese ne zbatim te ligjit nr.9920 , dt 19.08.2008 “Per Procedurat Tatimore ne RSH”, nenet 90 e 91. Keto masa do te ashpersohen dhe me shume duke shkuar ne bllokimin e aktiviteti te tyre deri ne likuidimin e plote te detyrimit.

#### **4 – Taksa e truallit**

Te ardhurat nga kjo takse realizuar ne shumen e 4 273 821 leke kundrejt 4 430 000 leke qe eshte plani ose **97 %** . Kjo takse ne masen me te madhe realizohet nga taksimi mbi truallin qe administron kompania shtetërore e naftes Albpetrol sh.a. ne territorin e bashkise Kuçove.

#### **5 - Taksa e regjistrimit te mjeteve te perdorura**

Te ardhurat nga taksa e regjistrimit te mjeteve te perdorura realizohet nepermjet DRSHTR Berat si agjent tatimor , per vitin 2018 ajo eshte realizuar ne shumen 11 173 593 leke ndaj 7 980 000 leke te planifikuara ose **140 %**.

#### **6 – Tarifa e zenies se hapsires publike**

E ardhura nga tarifa e zenies se hapsires publike realizohet nga sipermarria taksapaguesve te biznesit te madh, biznesit te vogel , te tregut te perqendruar dhe ne tregun e lire ata qe shfrytezojne keto hapësira publike te cilet kane nje kontrate me bashkine. Kjo e ardhur per vitin 2018 eshte realizuar 95 % dhe sipas taksapaguesve paraqitet si me poshte:

ne 000/leke

| Emertimi  | Bashkia | B.Madh | B.Vogel | Treg.Perq. | Tregu lire |
|-----------|---------|--------|---------|------------|------------|
| Plani     | 9 610   | 340    | 1 170   | 6 500      | 1 600      |
| Fakti     | 9 113   | 250    | 981     | 6 263      | 1 619      |
| Diferenca | 479     | 90     | 351     | -237       | + 19       |
| Ne %      | 95      | 71     | 84      | 97         | 101        |

Tabela e mesiperme tregon qarte per nje pune serioze per arketimin e detyrimeve nga kjo tarife, dhe ne ndryshim nga viti 2017, evidentohet permiresim ne arketimin e detyrimeve nga tregaret e tregut te perqendruar, duke perdorur te gjitha format shtrenguese per disiplinimin e tyre. Per ata qe do te rezultojne debitor mbas dates 20/01/2018 nuk do tju lidhet kontrata me bashkine per vitin 2019 dhe do perdoren format e pageses alternative deri ne arketimin e plote te detyrimit te prapambetur. Per detyrimet e paarktuara nga biznesi i madhe dhe ai i vogel po vazhdohet me masat shtrenguese paralel me detyrimet e tjera .

#### **7 – Tarifa e ndikimit ne infrastrukture**

Te ardhura e planifikuara nga kjo tarife ( ndertimet e reja + legalizimet) planifikuar 16 000 000 leke dhe ne fakt jane realizuar 6 478 819 leke ose **41 %**, e ardhur kjo qe arketohet prej Drejtorise se Urbanistikes qe kerkon nje planifikim me te mire te kesaj tarife ne baze te kerkesave per ndertime te reja dhe ato te futura ne proces legalizimi.

**8 – Taksa e fjetjes ne hotel** eshte realizuar ne shumen e 477 225 lek kundrejte planit prej 300 000 leke, apo ne masen relative 159 %. Ko takse arketohet nga njesite administrative ku ndodhen dhe realizohet sherbimi hotelier.

**9 – Takse per therje bagetie** planifikuar ne shumen 50 000 leke dhe ajo eshte realizuar ne shumen e 62 200 leke ose 124.4 %. Kjo takse eshte planifikuar me pak se nje vit me pare, si efekt i ndryshimeve ligjore ne kete fushe, me perqendrimin e thertoreve( Kuçova nuk disponon aktualisht Thertore) dhe respektivisht ofrimin e sherbimit veteriner nga drejtori te bashkive te tjera.

#### **II- Te ardhurat jotatimore**

Te ardhurat jotatimore per vitin 2018 jane planifikuar 105 552 000 leke dhe jane realizuar ne shumen 90 557 000 leke ose 85.7 %, me konkretisht do ti analizojme se si jane realizuar per çdo ze.

#### **1 – Tarifate sherbimi -Pastrim + Ndricim +Gjelberim**

Te planifikuar per te gjithë taksapaguesit sipas tarifave te miratuara ne paketen fiskale te vitit 2018 ato realizohen ne shumen 29 532 324 leke ndaj 38 160 000 leke te planifikuara ose **77 %** , por si jane realizuar sipas grupeve te taksapaguesve te bashkise dhe sipas njesive administrative atje ku ofrohen keto sherbime paraqiten si me poshte vijon :

sipas grupeve te taksapaguesve

ne 000/leke

| Emertimi  | Totali | Nderm/Inst | Familjar | B.Madh | B.Vogel |
|-----------|--------|------------|----------|--------|---------|
| Plani     | 38 160 | 4120       | 19 340   | 4 786  | 9 914   |
| Fakti     | 29 537 | 3835       | 12 975   | 2 842  | 9 885   |
| Diferenca | 8 628  | -285       | -6 365   | -1 944 | -29     |
| Ne %      | 77     | 93         | 69       | 60     | 100     |

Sipas njesive administrative:

ne 000/leke

| Emertimi  | Bashkia | Kuçove | Kozare | Perondi | Lumas |
|-----------|---------|--------|--------|---------|-------|
| Plani     | 38 160  | 28 487 | 2171   | 4212    | 260   |
| Fakti     | 29 537  | 23 816 | 1277   | 2099    | 231   |
| Diferenca | 8 628   | -4 671 | -894   | -2113   | -29   |

|      |    |    |    |    |    |
|------|----|----|----|----|----|
| Ne % | 77 | 85 | 59 | 50 | 89 |
|------|----|----|----|----|----|

Pra siç shihet nga tabelat e mesiperme keto tarifa sherbimi nuk janë realizuar në grupin e taksapaguesve familjar dhe ato të biznesit të madh dhe sipas njesive administrative me mos realizim paraqiten njesite Kozare, Perondi . Per debini e krijuar në vite nga taksapaguesit, vecanerisht atë të biznesit të vogël e të madh, keto janë trajtuar me përparësi nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave si të gjitha detyrimet e tjera të parakaltruara që u trajtuan me sipër duke zbatuar nën 90 dhe 91 të ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 “Per Procedurat Tatimore në RSH” duke ju bërë bllokimin e llogarive bankare si ato të subjekteve dhe ato personale , duke ju vënë dhe barrën hipotekore për pasurinë në ZRPP Kuçovë dhe barrën siguruese në DRSHTRR Berat. Masat shternguese për detyrimet e vitit 2017 në periudhën Tetor –Dhjetor është zbatuar për 117 debitor të biznesit të madh dhe atij të vogël, reagimi ka ardhur në 35 subjekte të biznesit të vogël dhe 6 subjekte të biznesit të madh.Në vazhdim të përpjekjeve dhe në funksion të zbatimit të ligjit për masat shternguese, do të vazhdojë gjatë muajit Shkurt 2019 me bllokimin e aktiviteteve deri në arketimin e detyrimeve të prapambetura të vitit 2018, për çdo subjekt të biznesit të madh apo të vogël dhe për ndermarrjet e institucionet, duke integruar përpjekjet e të gjithë stafit të bashkisë, korelacion të vazhdueshëm dhe efikas me Agjentet Fiskal, bashkëpunimin me Policinë Bashkiake, nën drejtimin dhe monitorimin e Kryetarit të bashkisë

## **2 – Qera toke bujqesore dhe pyjore**

Të ardhura të planifikuara për qerat e tokës bujqesore dhe asaj pyjore janë në shumën 12 278 000 leke dhe janë arktuar 2 881 839 leke ose 24 % e planit . Në këtë plan janë planifikuara të ardhura nga toka bujqesore dhe ajo pyjore që janë asetë të Bashkisë , realisht arketohen të ardhura vetëm nga qeraja për token bujqesore, mbi bazën e kontratave për 99-vjet në njesite administrative Perondi dhe Lumas që zënë shumën e 2 478 000 leke dhe nga kjo është arketuar 2 164 000 leke ku në indeks relativ paraqitet njesia Perondi që këtë të ardhur e ka realizuar 86.4 % dhe Lumasi 88.28 %.

Në planin e qerave nga toka bujqesore ka qenë të planifikuara për njesinë Kozare 720 000 leke, nderkaq janë arketuar 420 254 leke ose 58.4 % e programit,ndersa për njesinë administrative Lumas janë planifikuara 540 000 leke nuk janë arketuar për problem konflikt prone, asnjë lek për vitin 2018. .

## **3 – Tarife ndotje nga hidrokarburet**

Kjo tarifë është aplikuar për herë të parë në vitin 2017 për kompaninë e Albpetrolit që zhvillon aktivitetin në teritorin e Bashkisë Kuçovë dhe nga kjo tarifë e planifikuara për vitin 2018 në shumën 31 265 000 leke, u arketuan 31 875 000 leke, sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak nr 56 datë 04.10.2017, “Per Paketën Fiskale 2018” që konsiderohet në zbatim të ligjit nr.139/2015, dt.17/12/2015 “Per Veteqeverisjen Vendore”, nëni 35 , pika 5/ç “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”. Gjatë vitit ushtrimor 2018, jemi përballur me Ankimimin administrativ dhe me pas atë ligjor(gjykatën administrative), nga subjekti Albptrol sh.a, si dhe subjekti tjetër që operon në fushën e hidrokarbureve “Sherëood LTD”, i cili ka ankimuar të gjithë detyrimet vjetore, që burojnë nga paketa fiskale.

## **4 – Të ardhura nga tarifa për leje transporti dhe parkimi**

Të ardhura nga këto dy tarifa janë realizuar nëpërmjet shërbimit që ofrohet nga Drejtoria e shërbimit për mjetet e transportit të mallrave dhe taksi që kërkohej të pajisen me leje transporti dhe certificate transporti .Në vëmendjen e planifikimit për vitin 2018, janë përjashtuar shoqëritë e transportit për udhëtarët të cilat prej vitit 2017, e drejta e lejeve të transportit i kalojë ministrisë perkatese, kështu të ardhurat për vitin 2018 nga këto tarifa janë realizuar në shumën 558 000 leke ndaj 500 000 leke të planifikuara pra 112 %.

## **5 – Të ardhurat nga kopeshte e çerdhet**

Të ardhurat nga këto shërbime që ofron Bashkia, për vitin 2018 janë realizuar në shumën 5 033 079 leke kundrejt 4 650 000 leke të planifikuara ose 108.2 % . Të ardhurat janë planifikuara mbi bazën e realizimeve të viteve të mëparshme , dhe realizimi është në varesë të familjeve që e kërkojnë këtë shërbim.

## **6 – Të ardhura nga debitorët në vite.**

Puna për arketimin e detyrimeve të prapambetura është detyrë përhershme dhe nga me të rëndësishme e drejtorisë së të ardhurave , pasi është përgjegjësi e saj për të reflektuar si dhe pse janë krijuar në vite dhe mundësitë që lidhen për arketimin e tyre , pra kërkohej një informacion me i plotë për çdo debitor, dhe masa specifike sipas natyrës së subjekteve

Drejtorinë e të Ardhurave Vendore në punën e saj për arketimin e të ardhurave të vitit apo dhe ato të mëparshme mbështetet në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Per Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar , në ligjin nr. 9920 , datë 19.05.2008 “Per Procedurat Tatimore në RSH” duke zbatuar afatet kohore të percaktuara në paketën fiskale të vitit 2018 , dhe nga mos arketimi në kohë i të ardhurave janë zbatuar dhe masat penalizuese për çdo ditë vonës me 0,06% si rezultat i saj janë arketuar 9 583 845 leke.

Tabela e realizimit të treguesve të të ardhurave e vitit 2018, ne 000/leke

| Nr       | Emertimi i të Ardhurave             | Totali       |              | Ne %        |
|----------|-------------------------------------|--------------|--------------|-------------|
|          |                                     | Plan         | Fakt         |             |
| <b>I</b> | <b>Te Ardhura Tatimore</b>          | <b>57827</b> | <b>38374</b> | <b>66.5</b> |
| 1        | Tatim fitim i thjeshtuar            | 1000         | 2230         | 117.5       |
| 2        | Tatim toke                          | 12855        | 6425         | 49.2        |
| 3        | Tatim ndertese                      | 12172        | 5317         | 42          |
| 4        | Tatim trualli                       | 4430         | 4274         | 97          |
| 5        | Takse e regjistrimit te mjeteve     | 8250         | 11174        | 140         |
| 6        | Takse e zenies se hapsires publike  | 1510         | 1229         | 82          |
| 7        | Tarife e ndikimit ne infrastrukture | 16000        | 6479         | 40.5        |



|           |   |                |                |             |
|-----------|---|----------------|----------------|-------------|
| 8         | Takse e fjetjes ne hotel  | 300            | 477            | 159         |
| 9         | Takse therje bagetie  | 50             | 62.2           | 124         |
| 10        | Takse tabele e reklame  | 560            | 419            | 75          |
| 11        | Te tjera taksa (tak. vend. etj)   | 400            | 195            | 49          |
| <b>II</b> | <b>Te Ardhura Jotatimore</b>  | <b>105 552</b> | <b>90 557</b>  | <b>85.7</b> |
| 1         | Qera toke   | 11028          | 2462           | 22.3        |
| 2         | Qera ndertese   | 0              | 65             |             |
| 3         | Leje transporti e tarife parkimi  | 500            | 558            | 112         |
| 4         | Tarife pastrimi   | 23830          | 18536          | 78          |
| 5         | Tarife ndriçimi   | 8800           | 6982           | 79.3        |
| 6         | Tarife gjelberimi   | 5530           | 4016           | 73          |
| 7         | Tarife zenie e hapës publike(Treg Perq. Lire)                                       | 8100           | 7884           | 97          |
| 8         | Te ardhura nga kopeshitet   | 2800           | 3673           | 131.2       |
| 9         | Te ardhura nga çerdhet  | 1850           | 1361           | 73.5        |
| 10        | Debitor (detyrime te mepareshme   |                | 9584           |             |
| 10        | Tjera gjoba   |                | 2001           |             |
| 11        | Te tjera tarifa sherbimi(kanale vadites,lend drusore, gj.pol bashk, rent miner etj) | 10600          | 820            | 8           |
| 12        | Tarife nga Gj.civile  | 200            | 3248           |             |
| 13        | Energji e tregut perqendruar  | 0              | 596            |             |
| 14        | Tarife ndotje nga hidrokarburet   | 31265          | 31875          | 102         |
|           | <b>Totali</b>   | <b>163 379</b> | <b>129 231</b> | <b>78.9</b> |

Duke analizuar me pergjegjshmeri treguesit sintetik te mesiperm, kerkohet nje reflektim serioz nga Drejtoria e te Ardhurave Vendore , Drejtoria e Planifikimit te Territorit , Drejtoria e Sherbimeve , Drejtoria e Zhvillimit Rural si dhe te Njesive Administrative Kozare , Perondi, Lumas dhe Kuçove, duke pergjithesuar pervojen positive ne arritjen e disa treguesve, njeheresh nepermjet evidentimit te mos-arritjeve kerkohet nje bashkerendim me i mire i punes ndermjet tyre per te bere te mundur eliminimin e problemeve te dala gjate vitit , zbatimin e te gjitha procedurave ligjore per çdo fermer a familjar per pronen apo sherbimet , per çdo subjekt qe zhvillon aktivitet ekonomik privat ne teritorin e bashkise , evidendimi i plote i tyre si dhe lidhja me detyrimin tatimor dhe arketimi e te ardhurave ne kohe.

Detyrat qe dalin nga kjo analize e te ardhurave jane:

1 – Hartimi i nje programi pune nga te gjitha drejtorite e bashkise dhe njesite administrative per evidentimin e taksapaguesve te rinj dhe perfshirja e tyre ne regjistrat e taksapaguesve familjar, te biznesit dhe institucioneve per te gjitha taksat dhe tarifate e sherbimeve, pra zgjerimi i baze se taksueshme

2- Pergatitja ne kohe e njoftim detyrimeve tatimore dhe shperndarja e tyre ne kohen e percaktuar me ligj dhe ne Paketën Fiskale per 2019, per te gjithë taksapaguesit e Bashkise, duke organizuar punen per pagesen e tyre sipas afateve te percaktuar

3 – Vazhdimi i punes se ngritur ne zbatim te masave shternguese ne zbatim te ligjit nr. 9920 , date 19.05.2008 “Per Procedurat Tatimore ne RSH” per te gjithë debitoret e evidentuar.

4 - Detajimi i planit te te ardhurave per çdo muaj per çdo njesi administrative ne baze te afateve te percaktuar ne paketën fiskale te vitit 2019, si dhe kryerja e analizes se realizimit te te ardhurave per çdomuaji duke nxjerre pergjegjesine per çdo individ apo njesi e institucion dhe raportimi ne keshillin bashkiak me detyra konkrete.

Te ardhura faktike:

| • TE ARDHURAT |                               | VITI; | 2015               | 2016               | 2017               | 2018               |
|---------------|-------------------------------|-------|--------------------|--------------------|--------------------|--------------------|
|               | <b>BUXHETI I TE ARDHURAVE</b> |       | <b>540,872,771</b> | <b>607,585,901</b> | <b>708,964,069</b> | <b>829,412,432</b> |
| <b>I</b>      | Te Ardhurat e Veta            |       | 108,390,179        | 102,976,646        | 135,082,985        | 129,231,392        |
| <b>II</b>     | Transferte e Pakushtezuar     |       | 99,530,700         | 118,949,858        | 153,153,258        | 152,991,000        |
| <b>III</b>    | Transferte e kushtezuar       |       | 325,885,335        | 280,202,313        | 277,152,030        | 373,899,906        |
| <b>IV</b>     | Transferte specifike          |       | 0                  | 87,898,718         | 101,768,293        | 110,319,161        |
| <b>V</b>      | Te Ardhura te trasheguara     |       | 7,066,557          | 17,879,945         | 41,807,503         | 62,970,973         |

c. SHPENZIMET- Buxheti për vitin 2016, është hartuar i detajuar dhe programimi i tij është mbështetur në kërkesat e ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, është miratuar me vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 06 dt. 31.01.2016 “Për Buxhetin e Bashkisë Kuçovë për vitin 2016”, i konfirmuar nga Prefekti me shkresë nr. 167/1 dt. 10.02.2016. Është respektuar kërkesa për financimin e shpenzimeve për investime nga granditë e pa kushtëzuar, deri në masën 40 për qind, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, pasi shpenzimet e planifikuara për investime arrijnë në masën 49%.

Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë për **vitin 2016** (buxheti fillestar), janë si në pasqyrën që vijon:

| Nr | Vendimi i K.B |            | P ë r sh k r i m i        | Të ardhura<br>(në lekë) | Struktura e shpenzimeve                     | Shpenzimet<br>(në lekë) |
|----|---------------|------------|---------------------------|-------------------------|---|-------------------------|
|    | Nr.           | Datë       |                           |                         |   |                         |
| 1  | 06            | 31.01.2016 | Miratim buxheti           |                         | Miratim buxheti                             |                         |
| 2  |               |            | Prog.të ardhura           | 201,200,000             | Art.600 Paga                                | 177,461,739             |
| 3  |               |            | Të ardhura te trasheguara | 13,000,000              | Art.601 Sig.shoqërore                       | 29,450,977              |
| 4  |               |            | Transferta e Pakushtëzuar | 118,949,858             | Art.602 Shpenz.Operative                    | 140,585,239             |
| 5  |               |            | Transferte e kushtëzuar   | 92,466,097              | Art.230-231 Investime                       | 58,830,000              |
| 6  |               |            | Të ardhura nga Legalizimi |                         | Funksionet e deleguara<br>(paga, sig, shoq) | Pak dhe nd              |
| 7  |               |            | Transferta e kushtëzuar   |                         | Transferte (606)                            | 12,738,000              |
| 8  |               |            | per Funksionet e deleguar |                         |   |                         |
| 9  |               |            |                           |                         | Fondi Rezervë+Kontigj+qark                  | 6,550,000               |
|    |               | Total      |                           | <b>425,615,955</b>      |   | <b>425,615,955</b>      |

-Ndarja e plan-buxheteve dhe detajimet e tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli, respektimi i strukturës buxhetore dhe burimeve të financimit janë bërë konformë udhëzimit standard të zbatimit të buxhetit.

Në buxhet janë reflektuar edhe ndryshimet e diktuar sipas nevojave të mbështetura në kriteret ligjore gjatë ushtrimit të veprimtarisë të miratuara me vendim të këshillit Bashkiak apo sipas udhëzimit standard dhe nga Nëpunësi Autorizues.

Në plan - buxhetet për vitin 2016 dhe 2017, është realizuar detajimi në nivel titulli, kapitulli, artikulli e nën artikulli duke respektuar disiplinën buxhetore sipas strukturës buxhetore dhe burimeve te financimit.

-Ruajtja e destinacionit të përdorimit dhe limitit të planifikuar të fondeve të planifikuara.

Sipas situacionit të shpenzimeve nuk ka raste të përdorimit të fondeve mbi limitet e përcaktuar në planifikimet e shpenzimeve sipas artikujve dhe kapitujve.

Buxheti i vitit 2017 është miratuar me vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 82, dt. 30.12.2016 “ Për buxhetin e Bashkisë Kuçovë për vitin 2017”, konfirmuar për bazueshmërinë ligjore nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën nr. 16/1 dt. 13.01.2017.

Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë për **vitin 2017**(buxheti fillestar), janë si në pasqyrën që vijon:

| Nr | Vendimi i K.B |            | P ë r sh k r i m i        | Të ardhura<br>(në lekë) | Struktura e shpenzimeve                   | Shpenzimet<br>(në lekë) |
|----|---------------|------------|---------------------------|-------------------------|---|-------------------------|
|    | Nr.           | Datë       |                           |                         |   |                         |
| 1  | 82            | 30.12.2016 | Miratim buxheti           |                         | Miratim buxheti                           |                         |
| 2  |               |            | Prog.të ardhura           | 201,650,000             | Art.600 Paga                              | 192,939,301             |
| 3  |               |            | Të ardhura te trasheguara | 1,000,000               | Art.601 Sig.shoqërore                     | 31,363,542              |
| 4  |               |            | Transferta e Pakushtëzuar | 143,153,000             | Art.602 Shpenz.Operative                  | 164,080,890             |
| 5  |               |            | Transferte e kushtëzuar   | 95,791,601              | Art.230-231 Investime                     | 34,428,468              |
| 6  |               |            | Të ardhura nga Legalizimi |                         | Funksionet e deleguara<br>(paga,sig,shoq) |                         |
| 7  |               |            | Transferta e kushtëzuar   |                         | Fondi i Veçantë(606)                      | 15,010,000              |
| 8  |               |            | per Funksionet e deleguar |                         | % e K.Qarkut(                             | 1,372,400               |
|    |               |            |                           |                         | Fondi Rezervë+Kontigj                     | 2,400,000               |
|    |               | Total      |                           | <b>441,594,601</b>      |   | <b>441,594,601</b>      |

Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë për vitin 2018 (të ardhura faktike, shpenzime faktike, përfshire dhe funksionet e deleguara), janë si në pasqyrën në vijim tabl:

| Nr | Vendimi i K.B |            | P ë r sh k r i m i              | Të ardhura<br>(në lekë) | Struktura e shpenzimeve  | Shpenzimet<br>(në lekë) |
|----|---------------|------------|---------------------------------|-------------------------|--------------------------|-------------------------|
|    | Nr.           | Datë       |                                 |                         |                          |                         |
| 1  | 70            | 22.12.2017 | Miratim buxheti                 |                         | Miratim buxheti          |                         |
| 2  |               |            | Të ardhura të veta<br>(faktike) | 129,231,392             | Art.600 Paga             | 201,456,044             |
| 3  |               |            | Të ardhura te trasheguara       | 62,970,973              | Art.601 Sig.shoqërore    | 32,502,340              |
| 4  |               |            | Transferta e Pakushtëzuar       | 152,991,000             | Art.602 Shpenz.Operative | 122,258,646             |
| 5  |               |            | Transferte e kushtëzuar         |                         | Art.230-231 Investime    | 190,809,100             |
| 6  |               |            | Transferte specifike            | 110,319,161             |                          |                         |

|   |       |                                |                    |                  |                    |
|---|-------|--------------------------------|--------------------|------------------|--------------------|
| 7 |       | Të ardhura nga Legalizimi      |                    | Transferte (604) | 2,168,980          |
| 8 |       | Transferta e kushtezuar        | 373,899,906        | Transferte (606) | 233,997,190        |
| 9 |       | perفشire Funksionet e deleguar |                    |                  |                    |
|   | Total |                                | <b>829,412,432</b> |                  | <b>783,192,300</b> |

(Në 2018 diferenca 624 mijë lekë transferuar në buxhetin e shtetit sipas aktrakordimit të të ardhurës së trashëguar, tab1 e tab 2). Sipas situacioneve përfundimtare, viti 2018 krahasuar me vitet 2016 e 2017 paraqitet si vijon tab2:

000 lekë

**Realizimi i buxhetit në vitet 2016, 2017 e 2018, treguesit kryesorë rezultojnë:**

| Nr | EMERTIMI<br>Sipas Artikujve<br>Te shpenzimeve | Viti 2016                            |                                 |              | Viti 2017                                |                                     |             | Viti 2018                                |                                     |           |
|----|---|--------------------------------------|---------------------------------|--------------|--|-------------------------------------|-------------|--|-------------------------------------|-----------|
|    |   | Plani<br>Vjetor<br>(me<br>ndryshime) | Fakti<br>progresiv<br>viti 2016 | Në<br>%      | Plani<br>Vjetor<br>(me<br>ndryshime<br>) | Fakti<br>progresi<br>v<br>viti 2017 | Në<br>%     | Plani<br>Vjetor<br>(me<br>ndryshime<br>) | Fakti<br>progresi<br>v<br>viti 2017 | Në<br>%   |
| a  | b   | 1                                    | 2                               | 3            | 4  | 5                                   | 6           | 8  | 9                                   | 10        |
| 1  | 600 - Paga                                    | 184,398                              | 159,519                         | 87           | 207,501                                  | 184,504                             | 89          | 208,757                                  | 201,456                             | 97        |
| 2  | 601 - Sig.shoq.Sh                             | 30,483                               | 27,468                          | 91           | 33,350                                   | 31,136                              | 93          | 33,232                                   | 32,502                              | 98        |
| 3  | 602-Shpenz.opera                              | 145,320                              | 71,693                          | 50           | 174,622                                  | 110,318                             | 63          | 174,785                                  | 122,259                             | 70        |
| 4  | Investime                                     | 107,869                              | 83,715                          | 78           | 0  |                                     |             | 230,358                                  | 190,809                             | 83        |
| 5  | Studime,Projektim                             | 7000                                 | 6235.2                          | 89           | 161,697                                  | 103,111                             | 64          |  |                                     |           |
| 6  | 604- Transferta                               | 5,811                                | 196                             | 3            | 4,974                                    | 894                                 | 17          | 10,943                                   | 1,544                               | 14        |
| 7  | 606-Ndihme<br>Ekonomike                       | 212,244                              | 210,3397                        | 99.1         | 208,624                                  | 206,618                             | 99          | 235,124                                  | 232,823                             | 99        |
| 8  | 606-Transferta                                | 10,308                               | 6,613                           | 64           | 13,212                                   | 9,412                               | 71          | 1,450                                    | 1,174                               | 81        |
| 9  | 609 fond rezerve                              |                                      |                                 |              |  |                                     |             | 235                                      | 0                                   | 0         |
|    | <b>Totali</b>                                 | <b>703,433</b>                       | <b>565,778</b>                  | <b>80.43</b> | <b>803,980</b>                           | <b>645,993</b>                      | <b>80.3</b> | <b>894,887</b>                           | <b>782,568</b>                      | <b>87</b> |

-Pagat janë realizuar në masën 87% të planit vjetor dhe Sigurimet 91% për vitin 2016, janë sipas strukturës së institucionit; kontratave të punës dhe dokumenteve të tjerë justifikues që ligjërojnë pagesat e pagave dhe sigurimeve.

-Shpenzimet Operative për vitin 2016 janë realizuar në masën 50% të planit vjetor.

-Investimet për vitin 2016 janë realizuar në masën përkatësisht 78% e planit vjetor dhe 89% për studim-projektme.

**Realizimi planit të buxhetit në vitin 2017** është, në masën 80%, treguesit kryesorë rezultojnë:

-Pagat janë realizuar në masën 89% të planit vjetor dhe Sigurimet 93% për vitin 2017 janë sipas strukturës së institucionit; kontratave të punës dhe dokumenteve të tjerë justifikues që ligjërojnë pagesat e pagave dhe sigurimeve.

-Shpenzimet Operative për vitin 2017 janë realizuar në masën 63% të planit vjetor.

-Investimet për vitin 2017 janë realizuar në masën 64% të planit vjetor. Pjesa prej 19.7% e përealizuar vjen si pasojë e mosrealizimit të të ardhurave në masën 66% ose 68,767 mijë lekë më pak se plani vjetor.

Janë likujduar plotësisht investimet në process nga viti 2016:

**Realizimi planit të buxhetit në vitin 2018** është, në masën 87% dhe treguesit kryesorë rezultojnë si vijon:

-Pagat janë realizuar në masën 97% të planit vjetor dhe Sigurimet 98% për vitin 2018 janë sipas strukturës së institucionit; kontratave të punës dhe dokumenteve të tjerë justifikues që ligjërojnë pagesat e pagave dhe sigurimeve.

-Shpenzimet Operative për vitin 2018 janë realizuar në masën 70% të planit vjetor.

-Investimet për vitin 2018 janë realizuar në masën 83% të planit vjetor. Mos realizimi i zërit shpenzimeve operative ka të bëjë me detyrimet e prapambetura për shërbimet publike, kryesisht për shërbimin e pastrimit dhe dekorit. Detyrimet për këtë zë shpenzimesh nuk janë likujduar si pasojë e mos realizimit të planit të të ardhurave të veta.

Për vitin 2016 shpenzimet operative në total janë planifikuar në shumën 149,544 mijë lekë dhe janë realizuar në shumën 75,783 mijë lekë ose 51%, ndërsa për vitin 2017, janë planifikuar në shumën 174,622 mijë lekë dhe janë realizuar në shumën 103,111 mijë lekë ose 64%, dhe në vitin 2018 janë planifikuar në shumën 174,785 mijë lekë dhe janë realizuar në shumën 122,258 mijë lekë ose 70%.

Nga analiza e treguesve financiarë rezulton se ka përmirësim të treguesve të vitit 2018 krahasuar me vitet e mëparshëm.

Më poshtë jepet detajimi dhe realizimi i shpenzimeve operative llogaria 602 (Bashkia Kuçove):

| Nr. | Emertimi i Materialit e | Viti 2016 | Viti 2017 | Viti 2018 |
|-----|-------------------------|-----------|-----------|-----------|
|-----|-------------------------|-----------|-----------|-----------|

| Llogarise | sherbimit                                       | Plan          | Fakt          | Dif           | %         | Plan           | Fakt          | Dif           | %         | Plan           | Fakt          | Dif           | %         |
|-----------|---|---------------|---------------|---------------|-----------|----------------|---------------|---------------|-----------|----------------|---------------|---------------|-----------|
| a         | b   | 1             | 2             | 3             | 4         | 5              | 6             | 7             | 8         | 9              | 10            | 11            | 12        |
|           | <b>Totali 602</b>                               | <b>90,596</b> | <b>38,877</b> | <b>16,687</b> | <b>43</b> | <b>104,752</b> | <b>54,486</b> | <b>50,266</b> | <b>52</b> | <b>112,102</b> | <b>71,289</b> | <b>40,814</b> | <b>64</b> |
| 6020      | Materiale zyre dhe te Pergji                    | 1,921         | 597           | 1,324         | 31        | 2,008          | 1,276         | 732           | 64        | 1,887          | 1666          | 221           | 88        |
| 6020100   | Kanceleri                                       | 500           | 101           | 399           | 20        | 636            | 443           | 193           | 70        | 713            | 642           | 71            | 90        |
| 6020200   | Shpenzime materiale pastrim dizifektim e        | 350           | 31            | 319           | 9         | 179            | 77            | 102           | 43        | 105            | 33            | 72            | 31        |
| 6020300   | Materiale per funksionimin e Pajisjeve te zyres | 580           | 172           | 408           | 30        | 650            | 466           | 184           | 72        | 687            | 655           | 32            | 95        |
| 6020400   | Materiale per funksionimin e paisjeve speciale  | 81            | 74            | 7             | 91        | 2              | 2             | -             | 100       | 82             | 80            | 2             | 98        |
| 6020500   | Blerje Dokumentacioni                           | 290           | 159           | 131           | 55        | 413            | 252           | 161           | 61        | 250            | 221           | 29            | 88        |
| 6020900   | Furnizime me materiale zyre e te pergjithshme   | 120           | 60            | 60            | 50        | 128            | 36            | 92            | 28        | 50             | 35            | 15            | 70        |
| 60210     | Materiale dhe sherbime Speciale                 | <b>596</b>    | <b>437</b>    | 159           | 73        | <b>252</b>     | 35            | 217           | 14        | 330            | 63            | 267           | 19        |
| 6021001   | Uniforma eveshje speciale                       | 416           | 370           | 46            | 89        | 150            |               | 150           | 0         | 250            | 0             | 250           | 0         |
| 6021006   | Pajsje per perdorim policor                     | 20            |               |               | -         |                |               | -             |           |                |               |               |           |
| 6021007   | Libra dhe Publikime                             | 20            |               | 20            | -         | 20             |               | 20            | 0         |                |               |               |           |
| 6021099   | Te tjera materiale dhe sherbime Speciale        | 140           | 67            | 73            | 48        | 82             | 35            | 47            | 43        | 80             | 63            | 17            | 79        |
| 6022      | Sherbime nga te tretet                          | <b>2,106</b>  | <b>1,122</b>  | <b>753</b>    | 53        | 2,260          | 1,664         | 596           | 74        | 2938           | 2124          | 814           | 72        |
| 6022001   | Energji Elektrike                               | 95            | 94            | 1             | 99        | 147            | 142           | 5             | 97        | 170            | 126           | 44            | 74        |
| 6022002   | Konsum Uji                                      | 362           | 285           | 77            | 79        | 488            | 338           | 150           | 69        | 538            | 492           | 46            | 91        |
| 6022003   | Telefon   | 1,059         | 485           | 574           | 46        | 1,155          | 829           | 326           | 72        | 394            | 381           | 13            | 97        |
| 6022004   | Posta dhe sherbim Korrier                       | 350           | 249           | 101           | 71        | 340            | 316           | 24            | 93        | 695            | 562           | 133           | 81        |
| 6022010   | Sherbime te printimit e publikimit              | 100           | 9             |               | 9         | 90             | 39            | 51            |           | 40             | 0             | 40            | 0         |
| 6022099   | sherbime tjera                                  | 140           |               |               | -         | 40             |               | 40            | 0         | 1101           | 563           | 538           | 51        |
| 6023      | Shpenzime transporti                            | 6,518         | 4,139         | 2,379         | 64        | 9,067          | 5,481         | 3,586         | 60        | 15342          | 7908          | 7434          | 52        |
| 6023100   | Karburant dhe vajra                             | 5,600         | 3,650         | 1,950         | 65        | 6,694          | 4,778         | 1,916         | 71        | 8460           | 5787          | 2673          | 68        |
| 6023200   | Pjese Kembimi,goma bateri                       | 604           | 411           | 193           | 68        | 1,853          | 386           | 1,467         | 21        | 5673           | 1543          | 4100          | 27        |
| 6023200   | Shpen. Siguracioni                              |               |               |               |           |                |               |               |           | 350            | 145           | 205           | 41        |
| 6023900   | Shpenzime te tjera Transporti                   | 314           | 78            | 236           | 25        | 520            | 317           | 203           | 61        | 889            | 433           | 456           | 49        |
| 6024      | Shpenzime udhetimi                              | <b>800</b>    | <b>92</b>     | 708           | 12        | 400            | 176           | 224           | 44        | 500            | 183           | 317           | 37        |
| 6024100   | Udhetim i Brendshem                             | 400           | 92            | 308           | 23        | 400            | 176           | 224           | 44        | 500            | 183           | 317           | 37        |
| 6024200   | udhetim i jashtem                               | 400           |               | 400           | -         |                |               | -             |           | 0              | 0             | 0             | 0         |
| 6025      | Shpenzime per mirembajtje                       | <b>706</b>    | <b>70</b>     | 636           | 10        | 176            |               | 176           | 0         | 110            | 28            | 82            | 25        |
| 6025300   | Shpenz. mirem.Objekte ndertimore                | 200           |               | 200           | -         | 90             |               | 90            | 0         |                |               |               |           |
| 6025400   | Shpenz. mirem.rrugeve rrjeteve e Vepra ujqore   | 70            | 57            | 13            | 81        |                |               | -             |           |                |               |               |           |
| 6025500   | shp.mirmb mjete transp                          |               |               | -             |           |                |               | -             |           | 60             | 8             | 52            | 13        |
| 6025800   | Shpenzime per mirembajtjen e                    |               |               |               |           |                |               |               | 0         |                |               |               |           |



|         |  |               |              |        |    |        |        |        |     |       |       |       |     |
|---------|--|---------------|--------------|--------|----|--------|--------|--------|-----|-------|-------|-------|-----|
|         | paisjeve te zyrave   | 436           | 13           | 423    | 3  | 86     |        | 86     |     | 50    | 20    | 30    | 40  |
| 6027    | <b>Shpenzime per detyrime dhe kompensime legale</b>                |               |              | -      |    | 1,800  | 1,300  | 500    | 72  | 1786  | 1780  | 6     | 100 |
| 6027400 | Shpenzime per ekzekutim te vendimeve gjyqesore per largim nga puna |               |              | -      |    | 1,800  | 1,300  | 500    | 72  | 1054  | 1049  | 5     | 100 |
| 6027500 | Shpenzime per ekzekutim te vendimeve gjyqesore                     |               |              |        |    |        |        |        |     | 732   | 731   | 1     | 100 |
| 6029    | Shpenzime te tjera operative                                       | <b>19,526</b> | <b>6,419</b> | 13,107 | 33 | 11,013 | 6,437  | 4,576  | 58  | 11770 | 8861  | 2909  | 75  |
| 6029001 | Shpenz.pritje percjellje   | 150           | -            | 150    | -  |        |        | -      |     |       |       |       |     |
| 6029002 | aktivitete   |               |              | -      |    |        |        | -      |     |       |       |       |     |
| 6029003 | Shpenzime gjyqesore  | 1,250         | 1,116        | 134    | 89 | 736    | 542    | 194    | 74  | 200   | 0     | 200   | 0   |
| 6029006 | Shpenzime Kompesime per te zgjedhur                                | 6,420         | 5,155        | 1,265  | 80 | 8,211  | 5,494  | 2,717  | 67  | 9560  | 8465  | 1095  | 89  |
| 6029099 | Te tjera shpenzime Operative                                       | 11,706        | 148          | 11,558 | 1  | 2,066  | 401    | 1,665  | 19  | 2010  | 396   | 1614  | 20  |
| 6022    | sherbime publike   | 51,813        | 21,112       | 30,701 | 41 | 74,401 | 34,742 | 39,659 | 47  | 77439 | 48676 | 28764 | 63  |
|         | Shpenzime per transportin e nunesve                                | 6,610         | 4,889        | 1,721  | 74 | 2,954  | 2,954  | -      | 100 |       |       |       |     |
|         | Per zgjedhje   |               |              | -      |    | 421    | 421    | -      | 100 |       |       |       |     |

Sipas pasqyrës më sipër vërehet se nga Bashkia Kuçovë zëri “shpenzime operative” është realizuar duke mos tejkaluar parashikimin.

Në këtë zë peshën më të madhe si në planifikim ashtu edhe realizim e zënë shpenzimet për shërbime publike të planifikuara në total në vlerën 77,439 mijë lekë dhe të likujduara në vlerën 48,676 mijë lekë. Shpenzimet faktike për çdo shërbim janë: shërbimi i pastrimit likujduar në vlerën 36,757 mijë lekë, dekori 1,155 mijë lekë, mirëmbajtje varrezash publike 4,291 mijë lekë dhe shpenzime për shpronësime në vlerën 6,473 mijë lekë.

Transferta e kushtëzuar për 2018 ishte në vlerën **373,899,906** lekë dhe është përdorur si vijon:

-Shpenzimet faktike për PAK dhe ndihmën ekonomike që financohet nga transferata e kushtëzuar janë në vlerën 220,665,270 lekë.

-Shpenzimet faktike për gjendjen civile janë në vlerën 4,229,540 lekë nga të cilat 625,000 lekë janë shpërblime për fëmijë të lindur dhe pjesa tjetër shkon për paga e sigurime shoqërore.

-209,125 lekë transfertë Entit të Banesave Berat për pagesë të bonusit të strehimit.

-101,000 lekë kompensim për demtim banese.

-148,694,969 lekë janë përdorur për investime dhe konkretisht:

- Rikonstruksion i Gjymnazit “5 Tetori”, 14,625,520 lekë.

- Rikonstruksion Banesave të komunitetit Rom dhe Egjiptian, 4,451,832 lekë.

- Rikonstruksion ndërtesë, kthim në banesa sociale, 18,631,124 lekë.

- Rikonstruksion i oborreve të shkollave “28 Nëntori” dhe “Gaqi Karakashi” në vlerën 10,807,942 lekë.

Transferta specifike për 2018 ishte në vlerën **110,319,161** lekë dhe është përdorur sipas destinacionit.

## 1. Investimet e përfunduara dhe në zbatim për vitin 2017 e 2018;

**1.1. Rikualifikimi urban i Lagjes nr.1, blloku “11 Janari”, me vlerë investimi 120 316 298 leke pa TVSH (financuar nga FZHR).**

Projekti parashikonte përfshirjen e tre rrugëve kryesore të bllokut “11 Janari”, atë të “Koco Koleci” vazhdim “Isa Boletini” dhe “Toli Shuke”, projekt ky që është realizuar nga ana e Drejtorisë së Urbanistikës dhe Strehimit, është lidhur kontrata me nr 2103 Prot, date 23.06.2017 me firmën fituese “Besta” sh.p.k & “Shkelqimi 07” sh.p.k. Afati kohor për zbatimin e punimeve që nga lidhja e kontratës është vendosur 6 muaj, dhe aktualisht realizimi i punimeve ka arritur në masën 100% të tyre.

Ky projekt përfshin një gjatësi totale prej 1390 ml dhe gjerësi totale prej 9m, nga ku 5 m janë asflat dhe 2x0.5m kuneta. Gjerësia e trotuarëve për kalimin e këmbësorëve është 1.5m në të dyja anët e rrugës.

Që nga momenti i fillimit të punimeve, Drejtoria e Urbanistikës dhe Strehimit kryesisht, si dhe përfaqësuesit e institucionit Bashkia Kuçovë si nënkryetarët apo dhe vet kryetari kanë ndjekur hap pas hapi të gjitha proceset e punës. Gjatë implementimit të projektit janë hasur probleme si në amortizimin e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza, në pikën e shkarkimit të ujërave të bardha dhe për këto është bërë pastrimi i kanaleve egzistuese. Probleme në lidhje me prishjen e mureve të objekteve në posedim të familjeve që u prekën nga ky projekt janë bërë negociata nga ana e specialistëve të Drejtorisë së Urbanistikës dhe Strehimit dhe vetë Kryetarit të Bashkisë me qytetarët për zgjidhjen e këtyre problemeve. Gjithashtu janë bërë takime me përfaqësuesit e kompanisë së Altelecom Sh.A për rrjetin e shpërndarjes të telekomunikacionit për spostimin e shtyllave egzistuese të rrjetit përkatës. Ndjekja e punimeve nga ana

e specialistëve të Drejtorisë së Urbanistikës dhe Strehimit kryesisht ka vazhduar deri në përfundim të gjithë projektit. Ka përfunduar zbatimi i plotë i projektit.

### **1.2-Rikonstruksioni i Shesheve dhe Fushave Sportive tek Shkollat “Gaqi Karakashi dhe 28 Nentori”, me vlere investimi 18 303 173 leke pa TVSH.**

Projekti parashikonte rikonstruksionin e shesheve të shkollave “Gaqi Karakashi dhe 28 Nentori”, kontrate e lidhur me Nr 2565, date 01.08.2017 me firmën fituese “ZDRAVO” sh.p.k. Afati kohor për zbatimin e punimeve që nga lidhja e kontratës është vendosur 3 muaj, realizimi i punimeve ka përfunduar.

Shkolla Gaqi Karakashi – projekti parashikonte rikonstruksionin e një sipërfaqe përrreth 4000m<sup>2</sup> të gjithë territorit të shkollës. Janë parashikuar punime për rindërtimin e fushës egzistuese të futbollit që ka qënë në gjendje të amortizuar, drenazhimi, mbushje me dhe, mbjellje bari dhe vendosjen e dy portave të reja. Gjithashtu, janë vendosur 12 shtylla ndriçimi në gjithë territorit të shkollës. Në këtë shkollë është ndërtuar një fushë të re për basketboll që mund të shfrytëzohet dhe për volejboll. Kjo fushë është trajtuar me shtresë çakulli, shtresë stabilizanti dhe me asfalto beton me ngjyrë. Hapësira e mbetur nga gjithë territorit të shkollës është trajtuar me shtresë stabilizanti dhe shtrime pllaka. Pjesë e rëndësishme e rikonstruksionit të sheshit të kësaj shkolle është dhe sistemi i gjelbërimit ku janë vendosur deri në 50 pemë dekorative. Për gjithë sportdashësit, apo ndjekësit e sportit, janë ndërtuar dhe shkallët për të ndjekur llojet e sportit që ofrohen në këtë shesh. Ky projekt përfshinte dhe ndërtimin e një piste vrapimi, e trajtuar me shtresë çakulli, stabilizant dhe me shtresë tartani. Rindërtimi i fushës së futbollit, ndërtimi i fushës basketbollit/volejbollit si dhe pistës së vrapimit është për të gjithë nxënësit e kësaj shkolle dhe komunitetin e interesuar në ndjekjen e sporteve që ofrohen në këtë shesh, realizimi i punimeve ka përfunduar.

Shkolla 28 Nentori – projekti parashikonte rikonstruksionin e një sipërfaqe përrreth 3500m<sup>2</sup> të gjithë territorit të shkollës. Janë parashikuar punime për rindërtimin e fushës egzistuese të futbollit që ka qënë në gjendje të amortizuar, drenazhimi, mbushje me dhe, mbjellje bari dhe vendosjen e dy portave të reja. Është ndërtuar një kënd sportiv e trajtuar me shtresë çakulli, stabilizant dhe me shtresë tartani. Për sistemin e gjelbërimit janë vendosur 24 pemë dekorative dhe sistemi i ndriçimit me vendosjen 12 shtylla ndriçimi.

### **1.3- Sistemim, asfaltim i rruges Urë Vajgurore -Kucove- Dragot;**

Sa i takon projekteve strategjike të infrastrukturës, Plani Kombëtar 2015-2030 parashikonte që në Kuçovë të kalohet Boshti Qendror Jugor dhe ky është një nga investimet më të rëndësishme të infrastrukturës rrugore që pritet të ndërtohet në vendin tonë. Segmenti rrugor i këtij projekti përfshin ndërtimin e rrugës nga kufiri me bashkinë Ura Vajgurore duke vazhduar në fshatrat Rreth Tapi- Kozare- Vlashuk të territorit të bashkisë Kuçovë duke sjellë një lidhje më të mirë ndërmjet bashkive në rajon dhe një tjetër mënyrë aksesimi për Bashkinë e Kuçovës, krahas Fier-Sheganit dhe Urës Vajgurore.

Ndër projektet prioritare të bashkisë ka qënë pjesë dhe segmenti i Ura Vajgurore – Kuçovë, i cili u financua nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

### **1.4 Rivitalizimi i Fushave se Sportit;**

Fusha e sportit në lagjen nr 1, blloku “11 Janari”, është një tjetër projekt që sjell rizhvillimin e zonës dhe kthen fushën në funksionin e mëparshëm, atë sportiv. E gjithë fusha ishte e degraduar fizikisht, jo e frekuentuar nga sportdashësit, kishte mungesa sigurie duke mos qënë cilësore sidomos në peridhën e dimrit ku kthehej në një zonë përmytje. Duke u nisur nga projekti “Rikualifikimin urban të lagjes nr 1, blloku 11 Janari” kjo fushë sportive u vendos ndër projektet prioritare të bashkisë Kuçovë. Bashkia Kuçovë, në momentin e parë që i është ofruar propozimi për rivitalizimin të fushës sportive, ka ofruar vënien në dispozicion të specialistëve të saj dhe punonjësve apo mjetet përkatëse që duhen për realizimin e punimeve. Investimi është bërë nga dhurues italianë dhe e gjithë zbatimi i punimeve është ndjekur kryesisht nga Drejtoria e Urbanistikës dhe Strehimit, apo dhe vet Kryetari i Bashkisë.

Në këtë projekt janë përfshirë punime për sistemimin dhe mbushjen me dhe për nivelimin e fushës sportive, drenazhimi me shtresë zalli të lartë lumi si dhe vendosja e tubeve të drenazhit çdo 10m në mënyrë tërthore për të bërë kullimin sa më të mirë të fushës. Është realizuar mbushja me dhe si dhe mbjellja e barit. Pritet të vendosen dhe katër portat përkatëse të dy fushave sportive.

Me mbylljen e ketyre investimeve Bashkia Kuçove shpreson që t’i japë një frymemarrje të re dhe të nxite zhvillimin ekonomik të lagjes me të vjetër të qytetit.

### **1.5 Rikonstruksioni i tualeteve të shkolles 9-vjecare Gaqi-Karakashi;**

Projekti u aplikua nga Drejtoria e Koordinimit & Zhvillimit Strategjik në bashkëpunim me Vullnetarin e Korpusit të Paqes. Fondi i këtij projekti është 223 490 mije leke e financuar nga Korpusi i Paqes dhe po zbatohet Agjensia e Sherbimeve Komunale. Janë realizuar 100% e punimeve, të cilat janë ndjekur nga afer nga Drejtoria e Koordinimit dhe Zhvillimit Strategjik dhe Korpusi i Paqes.

## **2. Projekte me financim nga fondet e vete Bashkise:**

### **2.1 Rikonstruksioni i rruges “Enver Bregu”;**

Projekti përfshin segmentin me gjatësi 840 m linear, me gjerësi asfalti 5m, bankine 0.5 m, me kunete 0.5 m dhe me trotuar 1.5 m nga njëri krah. Ky investim ndodhet në fshatin Rreth-Tapi Njesia Administrative Perondi, dhe arrin në vlerën 36 826 550 leke me TVSH. Ky projekt është i plotë, është zbatuar dhe është parashikuar të realizohet me fondet e vete Bashkise. Detyrimi i mbetur është parashikuar në buxhetin e vitit 2019.

Nga ana e Drejtorisë së Urbanistikës dhe Strehimit të bashkisë Kuçovë është realizuar projekti “Nga Rreth rrotullimi në hyrje të qendrës urbane Kuçovë deri në Ferme Partizani” konkretisht rruga “Enver Bregu”. Në vijim të projektit “*Sistemim, asfaltim i rruges Urë Vajgurore -Kucove- Dragot*” të investuar nga FSHZH ka dalë e nevojshme rikonstruksioni i rrugës “Enver Bregu” si një ndër projektet prioritare që

bashkia duhet të investojë si dhe janë bërë ndryshimet e nevojshme ne projektin në fjalë, realizimi i punimeve ka përfunduar.Me kete investim Bashkia Kucove shpreson qe te nxise zhvillimin ekonomik ne kete zone.

## 2.2 Ndërtimi i rrugës “Skrapari”;

Projekti i ndërtimit të rrugës “Skrapari” është në të njëjtat parametra me projektin “*Rikualifikimi urban i Lagjes nr1, blloku “11 Janari”*” me gjerësi totale prej 9m, nga ku 4m janë asflat dhe 2x0.5m kuneta. Gjerësia e trotuarëve për kalimin e këmbësorëve është 1.5m në të dyja anët e rrugës. Duke qënë pjesë e bllokut 11 Janari, është parë e arsyeshme që të bëhet dhe ky segment që është vijimësi e rrugës “Isa Boletini” dhe “Koco Koleci”.

Ky projekt është me vlere preventivi 28.795.326 leke, e ndare per vitin 2017 vlere e financimit te kesaj shtese do te jete 14.405.000 leke. Diferenca prej 14.390.326 leke do te financohet me buxhetin e vitit 2019, realizimi i punimeve ka përfunduar.

2.3 Mbulesa e stadiumit “**Bashkim Sulejmani**”, me vlere 1.476.030 leke, te financuar nga Federata Shqiptare e Futbollit. Ky investim ka perfunduar.

2.4 Rikonstruksion i kopeshtit nr-1 Kucove me vlere 8283891 leke me tvsh do të financohet më fondet e bashkise Kuçove.

Investime te kryera me fonde te buxhetit te shtetit:

2.5 Rikonstruksion i objekteve te komunitetit rom dhe egjiptian dhe banues ne zonat rurale me vlere 14 574 632 leke me tvsh.

2.6 Rikonstruksion i ish godines se riparimit te mjeteve te renda dhe adoptimi i saj ne banese sociale me vlere 19 104 427 leke me tvsh.

2.7 Shtese kati biblioteka Kucove me vlere 7779700 me tvsh.

2.8 Rikonstruksion i shkolles se mesme 5 tetori me vlere 51 196 879 leke me tvsh.

## 3.Projekte të aplikuara gjatë vitit 2018;

Bashkia Kuçovë ka aplikuar disa projekte për rivitalizimin e jetës së komunitetit si rikualifikimi i lagjeve të qytetit, rikualifikimi i hapësirave të gjelbërta dhe rikrijuese, përmirësimin e infrastrukturës parashkollore dhe shkollore, përmirësimin e infrastrukturës rurale, menaxhimin e mbetjeve urbane, etj. Projektet janë aplikuar në:

1. Programi i Zhvillimit Rajonal III, grante per kulturen, arsimin dhe sportin - Ndërtim Shtesë Kati Biblioteka Kuçovë.
2. Fondi Shqiptar i Zhvillimit, grante per arsimin, infrastrukturen vendore dhe rajonale – Rikualifikimi i Parkut Qëndror të Kuçovës” (ish-TEC).
3. Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural, Programi i Integruar i Zhvillimit Rajonal – Përmirësim i skemave të kanaleve vaditëse dhe kulluese
4. Programi i Integruar i Zhvillimit Rural në Shqipëri “Zhvillimi Rural i 100 fshatrave”-prioritetet për investim për fshatin turistik Kozare
5. Skema pilote rajonale e granteve të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (Prioritetet per investime 2018-2020 sipas Planit të Përgjithshëm Vendor) – dërgim investime prioritare sipas Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Projekt Buxhetit Afatmesëm 2018-2020.
6. Ministria e Armimit, Sporteve dhe Rinisë – Rikonstruksioni Shkollës së Mesme “5 Tetori”, Ndërtimi i Shkollës 9-vjeçare+kopështi për fëmijë në NJA Perondi”.

Gjithashtu Bashkia Kucove është pjesë e Projektit të menaxhimit të mbetjeve në qarkun e Beratit financuar nga Sekretariati i Shtetit për çështjet ekonomike i Ambasadës Zviceriane, si dhe e Programit të Infrastrukturës Bashkiake III/IV UK Berat-Kuçovë i Bashkëpunimit Financiar Gjermani, Zvicër me Shqipërinë dhe i zbatuar nga KFË.

## -DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL:

Për vitin 2018 Bashkia Kuçove ka trajtuar me fondet e saj 50 familje në nevojë me ndihmë ekonomike me fond 1,800,000 lekë. Familjet përfituese janë familje me problem social- ekonomike si: Gra të divorcuara , vajzë nënë, të vetmuara , persona me probleme shëndetësore etj.

Menaxhimi i rasteve të fëmijëve në risk kërkon një fond për shërbimet që duhet të marrë fëmija apo familja në nevojë e fëmijës në risk. Këto fonde kanë qënë në periudha të caktuara kohe dhe për të mbështetur fëmijët në risk.

NJMF. ka mbështetur për vitin 2018, 2 raste të fëmijeve nga familje në nevojë për pagesa në kopshte dhe çerdhe. Mbeshtetja ka qene per nje periudhe 6 mujore sipas vleresimit te NJMF.

Në tabelën e mëposhtme jepen të dhënat sipas kategorive përfituese për vitin 2017dhe 2018 me fonde nga buxheti i shtetit;

### Ndihmë ekonomike:

| Nr. | Njësia administrativ e | Viti 2017     |            | Viti 2018   |            |
|-----|------------------------|---------------|------------|-------------|------------|
|     |                        | Nr. familjeve | Fondi/lekë | Nr. familje | Fondi/lekë |
| 1   | Kuçovë                 | 282           | 15,494,854 | 156         | 1,099,990  |

|   |               |            |                   |            |                  |
|---|---------------|------------|-------------------|------------|------------------|
| 2 | Kozare        | 7          | 552,978           | 0          | 0                |
| 3 | Lumas         | 32         | 1,513,310         | 32         | 73,800           |
| 4 | Perondi       | 26         | 1,128,181         | 0          | 0                |
|   | <b>Totali</b> | <b>347</b> | <b>18,698,323</b> | <b>448</b> | <b>1,173,790</b> |

**- Persona me aftësi të kufizuar:**

| Nr. | Njësia administrative | Viti 2017  |                    | Viti 2018   |                    |
|-----|-----------------------|------------|--------------------|-------------|--------------------|
|     |                       | Nr.        | Nr. familjeve      | Nr. persona | Fondi/lekë         |
| 1   | Kuçovë                | 390        | 73,256,452         | 386         | 75,027,911         |
| 2   | Kozare                | 120        | 20,872,944         | 121         | 21,663,377         |
| 3   | Lumas                 | 183        | 34,487,344         | 178         | 32,470,696         |
| 4   | Perondi               | 158        | 31,070,790         | 173         | 33,391,836         |
|     | <b>Totali</b>         | <b>851</b> | <b>159,687,530</b> | <b>858</b>  | <b>162,553,820</b> |

**- Invalidë pune:**

| Nr. | Njësia administrative | Viti 2017  |                   | Viti 2018   |                   |
|-----|-----------------------|------------|-------------------|-------------|-------------------|
|     |                       | Nr.        | Fondi/lekë        | Nr. persona | Fondi/lekë        |
| 1   | Kuçovë                | 434        | 17,140,700        | 438         | 17,125,338        |
| 2   | Kozare                | 70         | 2,729,100         | 69          | 2,702,769         |
| 3   | Lumas                 | 88         | 3,490,800         | 85          | 3,372,085         |
| 4   | Perondi               | 104        | 4,039,200         | 90          | 3,996,390         |
|     | <b>Totali</b>         | <b>696</b> | <b>27,399,800</b> | <b>682</b>  | <b>27,196,582</b> |

**- Persona që kanë përfituar kujdestari paaftësie:**

| Nr. | Njësia administrative | Viti 2017  |                   | Viti 2018     |                   |
|-----|-----------------------|------------|-------------------|---------------|-------------------|
|     |                       | Nr.        | Fondi/lekë        | Nr. familjeve | Fondi/lekë        |
| 1   | Kuçovë                | 75         | 9,307,290         | 118           | 22,656,000        |
| 2   | Kozare                | 18         | 2,224,580         | 33            | 6,336,000         |
| 3   | Lumas                 | 36         | 4,374,260         | 65            | 12,480,000        |
| 4   | Perondi               | 37         | 4,598,555         | 54            | 10,368,000        |
|     | <b>Totali</b>         | <b>166</b> | <b>20,504,685</b> | <b>270</b>    | <b>51,840,000</b> |

**- Persona që kanë përfituar kujdestari verbërie:**

| Nr. | Njësia administrative | Viti 2017 |                  | Viti 2018   |                  |
|-----|-----------------------|-----------|------------------|-------------|------------------|
|     |                       | Nr.       | Fondi/lekë       | Nr. persona | Fondi/lekë       |
| 1   | Kuçovë                | 20        | 2,594,900        | 17          | 2,440,860        |
| 2   | Kozare                | 5         | 695,000          | 6           | 861,480          |
| 3   | Lumas                 | 12        | 1,783,550        | 11          | 1,579,380        |
| 4   | Perondi               | 8         | 1,169,990        | 10          | 1,435,800        |
|     | <b>Totali</b>         | <b>45</b> | <b>6,243,440</b> | <b>44</b>   | <b>6,317,520</b> |

**-MBROJTJA NGA ZJARRI DHE SHPETIMI:**

Ne zbatim të ligjit nr. 152 dt.21.12.2015 “Per Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpetimi”, Sektori i M.Z.Sh-se Kuçove ka përcaktuar kater prioritete ku do të mbeshtese veprimtarine e tij:

**1-NE MARRJEN E MASAVE PARANDALUESE PER MBROJTJEN E JETES SE KOMUNITETIT DHE TE PRONES.**

**2-NE FORCIMIN E GATISHMERISE SE EFEKTIVIT DHE MJETEVE NE DISPOZICION.**

**3-NE RRITJEN E AFTESIVE TEKNIKE,FIZIKE E PROFESIONALE TE EFEKTIVIT.**

**4-NE PERMIRESIMIN E INFRASTRUKTURES E REALIZIMIN E BUXHETIT**

**1-PER RRITJEN E MASAVE PARANDALUESE:** nga Sektori i M.Z.SH-se u perpilua plani i punes vjetore per parandalimin e zjarreve ne te gjithë drejtimet qe parashikon ligji.Ne kete plan u përcaktuan sipas cdo muaji kontrolli i subjekteve dhe te ndara sipas rrezikshmerise.

Ne periudhen e dimrit u planifikuan kontrole ne institucionet shteterore administrative,si subjekte qe ushtrojne aktivitet ne katet e para te pallateve,objektet me ngarkese te larte te perdorimit te energjise elektrike, bombulave te gazit,objekte qe kryejne procese teknologjike si perpunim druri,kimikate te ndryshme,objekte artizanale,etj.

Ne periudhen e veres, Qershor-Korrik-Gusht jane planizuar per kontroll objektet me rrezikshmeri te larte zjarri, jane kryer 32 kontrole ne te gjitha objektet shteterore dhe private mbi gjendjen e masave qe kishin mare per mbrojtjen nga zjarri.

Per kete prioritet ka qene gjendja e masave parandaluese ne Qendren e Prodhimit te Naftes, ne pikat e furnizimit ta automjeteve me karburant, ne pikat e shitjes se gazit, ne fabrikat e miellit,furrat e bukes, fasonet, shkollat,pikat e shitjes se mobiljeve, supermarketet etj.

Nga 26 kontrollet e kryera rezulton se pikat e karburanteve,pikat e shitjes se gazit te lengshem, ne depozitat e naftes, institucionet shteterore ka nje vleresim te masave te M.Z.Sh-se, ku paisjet jane ne gatishmeri, njohja dhe perdorimi i tyre nga punonjesit eshte e mire por duhet punuar me shume per menyren e perdorimit te tyre sidomos ne ato institucione ku punojne kryesisht femra. Nga kontrolli i ushtuar ne Q.P.N. ne depozitat e vogla 2 toneshe kishte problem me ambientin perreth tyre, pasi ato ishin te mbuluara nga ferrat dhe shkurret po keshtu dhe nje pjese e puseve. Ne nje sektor ne varesi te Albpetrolit ku jane dy depozita 50.000 toneshe me nafte nuk funksiononte sistemi i shkarkimit te depozitave ne depozita te tjera. Ky proces kryhet me ardhjen e autoboteve nga Patosi gje qe e veshtireson zgjidhjen e problemit. Ne pikat e shitjes se karburantit me pakice siuate eshte me e mire, fikset e dores i kane sipas projektit dhe ne afatet e duhura, personeli di perdorimin e mjeteve per fikjen e zjarrit, por hidrantet e ftohjes gjate veres duhet te vihen ne pune vecanerisht ne oret e pikut te temperaturave.

Gjate ketij viti jane dhene 32 akte teknike me vlere 68.000 leke, te vjela, jane bere 2 akte ekspertimi zjarri per Prokurorine me vlere 50.000 leke, te pa vjelura.

Rendesi i eshte kushtuar miratimit te lejeve te ndertimit duke kontrolluar projektin e M.Z.Sh-se dhe gjendjen ne terren ku do te ndertohet objekti. Nga sektori i M.Z.Sh-se jane dhene 5 certifikata te shfrytezimit te objekteve sipas projekteve qe kane. Gjithsej jane dhene 32 Akte Teknike ku 23 jane ripertitje dhe 9 jane te reja, si rrobaqepsi, magazine bujqesore, supermarket, mobileri, nderrim destinacioni dhe 4 jane shtesa banesash ne zone rurale.

## **2-PER FORCIMIN E GATISHMERISE:**

Gatishmeria e efektivitetit, automjetit dhe paisjave te tjera jane treguesi kryesor per realizimin e detyres per fikjen e zjarreve dhe shpetimin e jetes dhe prones se komunitetit.

Per kete, ne fillim te vitit u percaktuan objektivat sipas te cilave synohet:

1-Gatishmeria e efektivitetit dhe infrastruktures rrugore.

2-Gatishmeria e teknikes ne perdorim.

Per gatishmerine e efektivitetit dhe infrastruktures rrugore u percaktuan tre drejtime:

1- Sistemi i marjes se sinjalit dhe lajmerimit te efektivitetit per paraqitjen ne stacion.

2- Mjetet e menytrat e ardhjes ne stacion.

3- Koha e paraqitjes.

**Sistemi i lajmerimit** realizohet me dy sistemet, ate me celular dhe me telefonine fikse. Per kete behet kontroll ne instruktazhin qe zhvillohet ne kohën e nderrimit te sherbimit, por edhe gjate 24 oreshit. Eshte bere e qarte koha e hapjes se telefonit, menyra e pergjigjes ndaj telefonuesve, regjistrimi i te dhenave dhe vecanerisht adresa e sakte e objektit ku ka rene zjarri ose nevoja per nderhyrje per shpetim. Gjithashtu efektiviteti i eshte bere e qarte koha prej 30 minutash per mbritjen ne stacion dhe largimi jashte territorit te Bashkise do te behet me lejen e shefit te sektorit. U be e qarte dhe menyra e organizimit dhe mbritjes se efektivitetit qe jeton ne Berat mjetet dhe vendet e takimit. Per kete jane zhvilluar prova gatishmerie vecanerisht ne periudhen e veres.

### **Per infrastrukturen rrugore;**

Rendesi i eshte kushtuar evidentimit te rrugeve ku ka veshtiresi per futjen e automjeti vecanerisht ne blloqet e banesave nje kateshe qe jane te rrethuara me mure dhe gardhe te cilat veshtiresojne punen. Problematike eshte lagja 1Maji, 11 Janari, Tafil Skendo.

Veshtiresi ka ne zonat e puseve te naftes ku jane ndertuar banesa dhe futja ne keto rruge eshte e veshtire. Ne te gjithë objektet sidomos shkolla kopeshte cerdhe eshte bere rikonicion per portat e hyrjes ne keto objekte pasi nje pjese nuk i kane ne vendet ku futen dhe nxenesit, si shkolla G.Karakashi, 28 nentori, kopeshti nr1. etj.

U hartua plan tematik i stervitjes tekniko profesionale, i ndare dhe specifikuar me muajt sipas programit te derguar nga Drejtoria e Pergjitheshme e M.Z.Sh-se ku u percaktuan temat te cilat kane te bejne me menyren e shuarjes se zjarrit ne pikat qe kane rezikshmerine me te larte, sic jane: zjarret ne depozitat e naftes, ne puset e naftes, ne kanalet e shkarkimit te mbetjeve teknologjike, ne qendren e perpunitimit te drurit, ne pikat e shitjes dhe mbushjes se bombulave gazit te lenget, ne pikat e furnizimit me karburant ne ambjente me dendesi popullore si ne shkolla kopeshte e cerdhe etj. Gjithashtu u percaktuan zonat te cilat jane te rezikuar nga permbytjet dhe rruge kalimet per mbritjen ne keto zona. Rendesi ju kushtua ne programin e stervitjes dhe rikonicionit te rrugeve ne zonen urbane, per percaktimin e zonave "te veshtira" per nderhyrjen e automjetit, me qellim qe efektiviteti te jete ne gjendje te percaktoje rrugekalimin me te afert dhe me te sigurt per ne objekt.

Per kete ne harten urbane te territorit te bashkise jane percaktuar dhe rruget me veshtiresi per futjen e automjetit.

### **Per automjetin dhe paisjet e tjera;**

Per mbajtjen ne gatishmeri te automjetit tip SKODA RTO, kete vit ka vazhduar puna ne gjendje te mire te automjetit nepermjet kontrollit te vazhdushem te tij, sipas udhezimeve per ndezjen cdo dite por dhe kryerja cdo te premt e sherbimit profilaktik sipas programit te miratuar.

Gjithashtu eshte bere nje pune e mire nga efektiviteti per eliminimin e difekteve qe kemi patur gjate vitit 2018 dhe te gjitha riparimet qe jane bere nga vete ai.

Difektet qe kemi patur kane qene ne pompen e ujit te motorrit, radiator, saracineskat, si dhe sistemi i frenimit dhe rrjedhjes se vajit. Keto difekte jane riparuar brenda nje kohe te shkurte kurse rrjedhja e vajit nuk eshte bere pasi kerkon nje kohe te gjete riparimi gje qe nxjer jashte gatishmerie automjetin per nje kohe prej tre ditesh. Rendesi i eshte kushtuar sherbimit profilaktik te mjetit qe zhvillohet cdo te premt. Per kete eshte bere plani profilaktik javor ku jane percaktuar detyrat e secilit, eshte ndjekur zbatimi i tyre dhe per cdo problem eshte nderhyre per zgjidhjen e tij.

Eshte bere vazhdimisht kontrolli i motopompe dhe motorgjeneratorit per te qene ne gjendje gatishmerie.

Kete vit u blene dy prezhektore 150 ė per ndricim, elektrik dore, lopata dhe shata per zjarre ne pyje e kullota.

Ne kuadrin e shtrirjes se rrjetit te ri te ujesjellsit eshte bere vazhdimisht kontrolli i hidranteve sipas nje plani te caktuar ku eshte mbajtur dhe procesverbali per cdo date kontrolli.

### **PER RRITJEN E AFTESIVE TEKNIKO, FIZIKE E PROFESIONALE.**

Per ritjen e aftesive profesionale me efektivitetin jane zhvilluar tema mesimore qe nga detyrat dhe radha e punes ne sherbim 24 oresh, deri tek plotesimi i dokumentacionit perkates pas situates operationale. Per kete u percaktuan detyrat e secilit gjate procesit te dorzimit dhe marrjes se detyres, radha e punes e secilit me marjen e njoftimit per zjarr.

Gjithashtu eshte bere instruktazh per menyren e plotesimit te raportit te sherbimit, fleten e njoftimit, detyrat pas kthimit nga situata, venia ne gatishmeri te automjetit dhe raportimi te eprori.

Ne drejtim te disiplines se punes eshte kerkuar qe te punohet sipas kerkesave te rregullores, ku ne kete vit nuk kemi patur shqetesime. Marrdheniet brenda kolektivitetit dhe me komunitetin kane qene te mira.



Me efektivin janë zhvilluar dy tema komplekse për, “Taktika e shuarjes së zjarrit në depozita naftë “në muajin Maj dhe “Taktika e shuarjes së zjarrit në pyje e kullota”, në muajin gusht.

Me gjithë punën e mirë që është bërë ka patur e mangësi të cilat me shunë kanë qenë në lidhje me rastet e nderhyrjes në zjarr ku nga ana e efektivit nuk janë zbatuar masat e sigurimit teknik për ruajtjen e jetës së tyre si nderhyrja pa skafanerin e kokës, kryerja e veprimeve pa doreza, qëndrimi i shoferit në kabine pavarësisht së çfarë lloji zjarri është, futja në objekt vetëm me k.gaz pa AP-3,etj. Gjithashtu dhe bashkëpunimi në grup të jetë me të mirë me qëllim që veprimet të jenë me efikasë.

Gjate këtij viti kemi pasur gjithsej **85 raste të veprimeve** operacionale të ndara si më poshtë:

-68 janë zjarre dhe shfaqje zjarri.

-17 janë nderhyrje

Te ndara në grupe rezultojnë si më poshtë:

**Grupi i parë** me kom.sherbimi K.Zjarrf.Ahmet Mema ka patur 17 dalje operacionale nga ku 13 raste shfaqje zjarr dhe 4 raste nderhyrje

**Grupi i dytë** me kom.sherbimi K.Zjarrf.Bilbil Selamaj ka patur 24 raste operacionale nga ku 19 raste shfaqje zjarri dhe 5 raste për nderhyrje

**Grupi i tretë** me kom.sherbimi K.Zjarrf.Ismet Sadikaj ka pasur 21 raste operacionale nga ku 18 raste shfaqje zjarri dhe 3 raste për nderhyrje.

**Grupi i katërt** me kom.sherbimi zjarrfikës Roland Agalliu ka patur 23 raste operacionale nga ku 18 raste shfaqje zjarri dhe 5 raste nderhyrje

Për zjarre dhe shfaqje zjarri kemi 68 raste, nga këto 13 raste në objekte civile, 5 raste në objekte sherbimi, salla, magazinte,4 raste në ambiente me rrezik të lartë zjarri puse naftë,1 raste në mjete transporti, 45 raste mbetje urbane.

Për nderhyrje kemi 17 raste, në hapje dërrësive të blinduara dhe bllokime tubacione të ujës jellës.

Në të gjitha operacionet gatishmeria e efektivit dhe veprimet e tij kanë qenë profesionale si grupit që ka qenë në sherbim, por edhe në rastet kur është dashur shtimi i forcave ka qenë e menjeherëshme. Bashkëpunimi me strukturat e tjera që janë parashikuar në planin e punës në rast të zjarreve masive si në 2 rastet e zjarrit në pyje dhe ulla, ka qenë shumë e mirë, vecanerisht me Drejtorinë e bujqësisë, të cilët kanë qenë të pranishëm në të dy rastet e zjarreve kur ka qenë e nevojshme ndihma e tyre, bashkë me strukturat e ngritura në Lumas për fikjen e zjarrit.

Realizimi i buxhetit është ndjekur në bashkëpunim me zyrën e financës ku realizimi ka qenë i mirë, sipas fondeve të parashikuara.

Te gjitha zërat janë realizuar sipas parashikimit me përjashtim të blerjes së uniformave për arsye të likuidimit të faturave të ujit të cilat rezultojnë në pa paguara nga Prefektura Berat.

#### **Per infrast.dhe kushtet e jeteses:**

Këtë vit u bë vendosja e tavaneve në tre ambiente të godinës dhe paisje e gjithë efektivit me dollape personal. Në plan ishte dhe shtrimi i garazhit me beton por nuk u realizua.

Duke parë shkurtimisht detyrat e parashikuara në fillim të vitit rezultojnë se në përgjithësi janë realizuar.

Për vitin 2019 problemet dhe mangësitë që do të evidentohen gjatë kësaj analize do të jenë objekt i punës si dhe:

1-Ritja e aftësive tekniko profesionale të efektivit për t’ju përgjigjur shpejt dhe me profesionalizëm i detyrave.

2-Ritja e forcimit të gatishmerisë së efektivit dhe teknikës.

3-Ritja e forcimit të masave parandaluese në të gjitha subjektet private dhe shtetërore.

#### **-POLICIA BASHKIAKE:**

Organizimi dhe funksionimi i drejtorisë së kësaj drejtorie, bazohet në ligjin 8224 datë 15.05.1997, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Bashkiake”.

Gjate kësaj periudhe është bashkëpunuar me Drejtorinë e të Ardhurave lokale. Bashkëpunimi me këtë drejtori me tepër ka konsistuar në mbarevajtjen e punëve në tregun e për qendruar dhe atë të lirë. Tek tregu i lirë është kontrolluar zbatimi i orarit të levizjes së mjeteve brenda tij si dhe mos lejimi i mjeteve të pa licensuara në të. Gjithashtu tek tregu i përqendruar është mundësuar lirim i 16 bokseve të zena në mënyrë të padrejtë dhe në kundërshtim me ligjin, për të cilët janë mbajtur procesverbalet për secilin prej tyre nga ana e komisionit të posaçëm.

Është bashkëpunuar sistematikisht me Drejtorinë e mjedisit, sidomos për problemin e mbajtjes së bagetive në ambiente publike, si në parqe, lulishte e shkolla të qytetit i cili ka qenë një problem shumë shqetësues për komunitetin tonë. Është bërë identifikimi nga ana e tyre dhe është kontaktuar me personat përgjegjës si dhe janë marrë masa administrative ndaj tyre.

Bashkëpunimi me Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit në konstatimin, parandalimin dhe prishjen e objekteve pa leje, ka qenë efikas dhe në mbështetje të plotë të veprimeve të tyre ligjore. Ky bashkëpunim ka qenë i përhershëm duke lënë gjurmë në subjektet përkatëse ku është ushtruar kontroll duke i pasqyruar veprimet tona me akte kontrolli, akte bllokimi, lënë detyrues etj. Bashkëpunimi me këtë drejtori ka qenë i vazhdueshëm në drejtim të monitorimit ndalimit dhe prishjes së ndertimeve pa leje si dhe të zënies të paligjshme të trojeve e objekteve publike të Bashkisë. Në këtë periudhe janë konstatuar dhe është bërë bllokimi i punimeve për 29 shtetas ndaj të cilëve janë ndjekur të gjitha procedurat ligjore.

Gjate këtij viti janë zhvilluar shumë aktivitete kulturore e sportive. Për çdo aktivitet të zhvilluar është përgatitur plan masash i vecantë si dhe është kërkuar bashkëpunim Policisë së shtetit. Kemi përballuar pa asnjë problem të gjitha aktivitetet kulturore e sportive të zhvilluara.

Bashkëpunimi me Policinë e Shtetit ka qenë korrekt dhe kështu shpresojmë të vazhdojë dhe me tej për të gjitha problemet që do të kërkojnë bashkëpunim.

Çdo ditë është bërë pritja e qytetarëve për problemet e ndryshme që ata kanë shtruar. U është dhënë zgjidhje të gjitha ankesave që janë paraqitur pranë zyrës sonë. Kur ankesat e paraqitura i kalonin kompetencat ligjore të Policisë Bashkiake problemet u janë deleguar zyrave përkatëse sipas ankesës.

Nje problem shqetesues gjate kesaj periudhe ka qene parkimi i mjeteve 4+1 tek sheshi para elektrikut te cilat parkonin kundra table, dhe konkuronin ne menyre te pandershme me taksite 8+1 te cilat jane te licensur dhe tatimpagues te rregullt. Ne bashkepunim dhe me policine rrugore i eshte dhene rruga e zgjidhjes ketij problemi. Gjate kesaj periudhes jane vendosur gjithsej 14 gjoba , nga te cilat 3 jane vendosur nga punonjesi B. Skenderi dhe 11 nga punonjesi V. Dragoti . Nga keto 6 gjoba jane vjele, per gjobat e tjera eshte dergur shkrese zyrtare per bashkepunim zyrave te Bashkise dhe zyres se gjendjes civile si dhe i jane derguar me poste qytetareve.

Nga kontrolloret e vazhdueshme te kryera ne territorin e Bashkise jane konstatuar probleme te ndryshme per te cilat jane mbajtur dhe akte kontrolle nga te cilat:

61 jane per zenie hapësire publike

12 jane per ndotje ambjenti

3 jane per ndotje akustike

Ne zbatim te vendimit te keshillit Bashkiak Nr.50 date 17.07.2016 “Per miratimin e vendit te nisjes dhe mberrijtes se autobuzave dhe agjensive te transportit te udhetareve ne Terminalin Kucove” jane marre te gjitha masat nga ana jone ne bashkepunim me Drejtorine e Sherbimeve per zbatimin e ketij vendimi, duke ngritur postobloqe dhe duke kontrolluar te gjithe linjat e autobuzave.

U eshte ardhur ne ndihme dhe ndermarjeve ne varesi te Bashkise sa here na eshte kerkuar per mbarevajtjen sa me te mire te puneve.

Eshte mbajtur kontakt i vazhdueshem me 3 Njesite Administrative te Bashkise dhe u eshte ardhur ne ndihme sa here eshte kerkuar nderhyrja e Policise Bashkiake.

Persa i perket maredhenieve vartes- epror kane qene te mira me disa perjashtime te vogla ne drejtim te komunikimit epror -vartes. Prezenca ne pune ka qene korrekte. Sigurisht qe ka akoma per te permiresuar ne drejtim te organizimit te punes dhe zgjidhjes se problemeve.

Si rrjedhoje per periudhen ne vazhdim dalin keto detyra:

- 1- Do të bashkepunohet me Drejtorine e te ardhurave ne drejtim te mbledhjes se taksave nga bizneset qe jane debitore, per evidentimin e bizneseve te pa licensuara dhe detyrimin e tyre ne rruge ligjore te paisjes me dokumentacionin perkates.
- 2- Do te kryhen kontrolle në terren per mos lejimin e zenieve te hapësirave publike, ndertimet pa leje, ruajtjen e parqeve dhe lulishteve.
- 3- Mbajtjen nen kontroll te vazhdueshem zones se gjelbert dhe goditjen me ashpersine e ligjit te demtusve te kesaj zone.
- 4- Bashkepunimi me te gjitha drejtorite e Bashkise dhe institucioneve te tjera si dhe me Njesite Administrative
- 5- Mbeshtetja dhe mbarevajtja e te gjitha aktiviteteve kulturore e sportive qe do te zhvillohen.
- 6- Bashkepunim te ngushte me Policine e Shtetit per zgjidhjen e problemeve ne te mire te komunitetit.
- 7- Do te punohet per ngritjen profesionale te sejcilit punonjes duke u njohur konkretisht me aktet ligjore e nen ligjore te cilat normojne punen tone.

### **-INSPEKTORIATI I MBROJTJES SE TERRITORIT VENDOR (IMTV):**

Gjate vitit 2018 nga ana e IMT, është monitoruar gjithë territori dhe për shkeljet e konstatuara janë vendosur 10 gjoba në vlerën 4 800 000 lekë.

a. Lista me Vendimet e Gjobave per vitin 2018 paraqitet si më poshtë:

| Nr. | Emer, Atesi, Mbiemer | Date e gjobes | Lloji i objektit dhe shkelja                       | Ligji, neni, pika | Gjobitur (leke) | Emri mbiemri inspektorit dhe data   | Nr. Serial |
|-----|----------------------|---------------|--|-------------------|-----------------|-------------------------------------|------------|
| 1   | Elmaz Tabaku         | 23.04.2018    | Ndertim pa leje cati                               | 107/2014, 52, e   | 500000          | R. Bakullari, J. Lezo<br>20.04.2018 | 000024     |
| 2   | Edmir Suli           | 23.04.2018    | Devijim i lejes se dhene                           | 107/2014, 52, i   | 300000          | R. Bakullari, J. Lezo<br>20.04.2018 | 000025     |
| 3   | Behar Kollcaku       | 07.05.2018    | Ndertim pa leje shtese kati                        | 107/2014, 52, e   | 500000          | R. Bakullari, J. Lezo<br>04.05.2018 | 000026     |
| 4   | Petrit Mustaj        | 14.05.2018    | Ndertim pa leje shkalle + verande                  | 107/2014, 52, e   | 500000          | R. Bakullari, J. Lezo<br>14.05.2018 | 000027     |
| 5   | Lefter Kallmi        | 21.09.2018    | Ndertim pa leje shtese kati                        | 107/2014, 52, e   | 500000          | R. Bakullari, J. Lezo<br>20.09.2018 | 000028     |
| 6   | Andon Ziu            | 21.09.2018    | Ndertim pa leje shtese anesore                     | 107/2014, 52, e   | 500000          | R. Bakullari, J. Lezo<br>20.09.2018 | 000029     |
| 7   | Todi Bucka           | 02.10.2018    | Ndertim pa leje cati                               | 107/2014, 52, e   | 500000          | R. Bakullari, J. Lezo<br>01.10.2018 | 000030     |
| 8   | Ervin Sheme          | 12.11.2018    | Ndertim pa leje bazament beton+konstruksion hekuri | 107/2014, 52, e   | 500000          | R. Bakullari, J. Lezo<br>08.11.2018 | 000031     |
| 9   | Iilir Brahaj         | 04.12.2018    | Ndertim pa leje Banese 1kt                         | 107/2014, 52, e   | 500000          | R. Bakullari, J. Lezo<br>03.12.2018 | 000032     |
| 10  | Vasil Gjika          | 06.12.2018    | Devijim i lejes se dhene                           | 107/2014, 52, e   | 500000          | R. Bakullari, J. Lezo<br>06.12.2018 | 000033     |
|     |                      |               |  | Totali i gjobave  | 4800000         |                                     |            |

**-SHERBIMET PUBLIKE:**

Mbi realizimin e treguseve dhe volumeve te sherbimeve publike per vitin 2018.

**1. Sherbimi i pastrimit, grumbullimit dhe transportimit te mbeturinave urbane:****Qyteti Kucove:**

| Nr. | Emertimi   | Njesia         | Sasia       | Çmimi/njesi | Dite pune/vit | Vlera     | Vlera Totale      |
|-----|--|----------------|-------------|-------------|---------------|-----------|-------------------|
| 1.  | Fshira me fshese dore e rrugeve dhe shesheve                                     | m <sup>2</sup> | 140 000     | 0,07485     | 312           | 3 269 303 |                   |
| 2.  | Fshirja me mjet teknologjik e rrugeve e shesheve                                 | “              | 30 000      | 0,22944     | 80            | 550 664   |                   |
| 3.  | Grumbullim e transportim te mbeturinave urbane ne vend depozitim (per kontenier) | ton<br>cope    | 22,5<br>240 | 114,545     | 312           | 8 577 129 |                   |
| 4.  | Sherbimi i pastrimit ne EC-te publike te qytetit                                 | “              | 4           | 973,5785    | 312           | 1 215 026 |                   |
| 5.  | Lagije rruge e sheshe me mjet teknologjik  | m <sup>2</sup> | 50 000      | 0,13783     | 207           | 1 426 536 |                   |
| 6.  | Heqja e mbetjeve inerte nga pikat e grumbullimit                                 | dite           | 312         | 5 432,2596  | 312           | 1 694 865 |                   |
| 7.  | Sistemimi i mbeturinave ne vend depozitim ne Fermen “Partizani”                  | “              |             | 12 383,9385 | 65            | 804 956   |                   |
|     | <b>Shuma</b>   |                |             |             |               |           | <b>17 538 479</b> |
|     | <b>TVSH 20%</b>  |                |             |             |               |           | <b>3 507 696</b>  |
|     | <b>Shuma totale</b>  |                |             |             |               |           | <b>21 046 175</b> |

**Njesia Kozare:**

| Nr. | Emertimi   | Njesia | Sasia | Çmimi/njesi | Dite pune/vit | Vlera     | Vlera Totale     |
|-----|--|--------|-------|-------------|---------------|-----------|------------------|
| 1.  | Grumbullim e transportim te mbeturinave urbane ne vend depozitim (per kontenier) | cope   | 95    | 315,002     | 104           | 3 112 220 |                  |
| 2.  | Heqja e mbetjeve inerte nga pikat e grumbullimit                                 | dite   |       | 17 590      | 12            | 211 080   |                  |
|     | <b>Shuma</b>   |        |       |             |               |           | <b>3 323 300</b> |
|     | <b>TVSH 20%</b>  |        |       |             |               |           | <b>664 660</b>   |
|     | <b>Shuma totale</b>  |        |       |             |               |           | <b>3 987 960</b> |

**Njesia Perondi:**

| Nr. | Emertimi   | Njesia         | Sasia | Çmimi/njesi | Dite pune/vit | Vlera     | Vlera Totale     |
|-----|--|----------------|-------|-------------|---------------|-----------|------------------|
| 1.  | Fshira me fshese dore e rrugeve dhe shesheve                                     | m <sup>2</sup> | 8 000 | 0,23125     | 104           | 192 400   |                  |
| 2.  | Grumbullim e transportim te mbeturinave urbane ne vend depozitim (per kontenier) | ton<br>cope    | 90    | 308,888     | 156           | 4 336 800 |                  |
| 3.  | Larja e konteniereve metalike  | “              | 45    | 355,555     | 24            | 384 000   |                  |
| 4.  | Lagije rruge e sheshe me mjet teknologjik  | m <sup>2</sup> | 8 000 | 0,75        | 26            | 156 000   |                  |
| 5.  | Heqja e mbetjeve inerte nga pikat e grumbullimit                                 | dite           |       | 14 300      | 52            | 743 600   |                  |
|     | <b>Shuma</b>   |                |       |             |               |           | <b>5 812 800</b> |
|     | <b>TVSH 20%</b>  |                |       |             |               |           | <b>1 162 560</b> |
|     | <b>Shuma totale</b>  |                |       |             |               |           | <b>6 975 360</b> |

Drejtoria e sherbimeve publike e ka patur ne qender te vemendjes realizimin e detyrave, zerave te punes dhe volumeve te sherbimit te pastrimit edhe gjate vitit 2018. Kujdesi yne ka patur si qellim ofrimin sa me cilesor te sherbimit te pastrimit, jo vetem ne qytetin Kucove por edhe ne njesite administrative Kozare dhe Perondi. Edhe pse ne njesine Lumas nuk ofrohet sherbimi i pastrimit ligjerisht dhe zyrtarisht, perseri nen kujdesin e kryetarit te bashkise firma sipermarres e sherbimit te pastrimit e ka ofruar privatisht kete sherbim dy here ne jave pa shperblim nga ana e bashkise, deri ne tetor te vitit 2018.

Sipas zerave te punimeve te ketij sherbimi, te percaktuara ne tenderin e hapur te sherbimit te pastrimit qe ne vitin 2011 ne qytetin Kucove jane respektuar zerat e punimeve dhe volumet e punimeve ne sherbimin e pastrimit.

-siperfaqe qe fshihet me fshese dore eshte 140 000 m<sup>2</sup> cdo dite. Kjo siperfaqe eshte e percaktuar sipas inventarit te rrugeve te qytetit Kucove. Por vitet e fundit na eshte shtuar siperfaqja e rrugeve per shkak te rikonstruksionit te disa prej rrugave kryesore. Kjo na ka detyruar qe te shtojme ne inventarin e rrugave siperfaqe te tjera, te cilat per tenderin e ardhshem te sherbimit te pastrimit kap shifren prej rreth 170 000 m<sup>2</sup> per tenderin e ri. Deri tani nuk kemi patur ankesa nga qytetaret per fshirjen e rrugave me fshese dore.

-fshirja me mjet teknologjik e rrugave dhe shesheve ne siperfaqen prej 30 000 m<sup>2</sup> per 80 dite ne vit.

Ne kete sherbim kemi futur rruget dhe sheshet qe jane ne qender te qytetit ku kerkohet nje mjedis i paster per shkak te trafikut te automjeteve dhe njerezve. Per kete sherbim kemi patur kerkese nga qytetaret per shtimin e diteve qe ofrohet ky sherbim, por deri tani per shkak te mungeses se fondeve financiare nuk e kemi realizuar dot, bile eshte hequr si ze ne tenderin e ri te ketij sherbimi. Megjithate ky sherbim ka funksionuar rregullisht.

-grumbullim e transportim te mbetjeve urbane me mjet teknologjik e konteniere cdo dite.

Eshte nje sherbim shume i rendesishem i sherbimit ndaj te cilit kemi treguar kujdesin maksimal per ta realizuar sa me mire, me standarte pa ankesa nga qytetaret. Per kete sherbim ne kemi ne dispozicion 240 konteniere metalike te shperndare ne te gjitha qytetin, pra mbulojme 100% te siperfaqes se sherbimit. Kemi gjithashtu ne dispozicion edhe tre mjete teknologjike qe punojne cdo dite per grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane

per ne vend depozitim e tyre.Kohet e fundit kemi patur kerkesa per shtimin e numrit te konteniereve sidomos ne zonat e reja te banimit si ne lagjen “11 janari”, rruga mbi fabriken e sallamit, te rruga e re U.Vajgurore – Kucove dhe disa prej lokaleve qe jane vendosur pergjate saj dhe ne brendesi te fshatit Tapi.Nuk kemi patur shqetesime te tjera per kete ze sherbimi, me disa shqetesime sidomos ne zonat periferike ne muajin nentor - dhjetor te vitit 2018.

-sherbimi i pastrimit te EC-ve publike gjithsej 4. Eshte nje sherbim i vecante qe ofrohet ne bashkine tone, pasi jane te ralla bashkite qe e kane nje sherbim te tille.Kete sherbim e kemi ofruar qe nga viti 1995 kur u be per here te pare kalimi i sherbimeve publike me sipermarrje private.Ky sherbim ofrohet cdo dite dhe deri tani nuk kemi patur ankesa, qytetaret jane te kenaqur me kete sherbim, por EC –te kane nevojte per rikonstrukcion.

-lagia e rrugeve dhe shesheve me mjet teknologjik ne siperfaqen prej 50 000 m<sup>2</sup> per 207 dite ne vit. Eshte nje sherbim mjaft i kerkuar nga qytetaret se ka te beje direkt me permiresimin e mjedisit.Ne kete sherbim kemi parashikuar rruget dhe sheshet kryesore te qytetit Kucove, por 2 vitet e fundit kjo siperfaqe eshte rritur dhe do te jemi te detyruar qe te rritim siperfaqen e rrugeve e shesheve qe lagen per cdo dite.Deri tani parashikojme qe te rritet kjo siperfaqe ne rreth 73 000 m<sup>2</sup> dhe shtim te diteve qe kryejme lagjen e rrugeve nga 207 dite/vit ne 220 dite /vit, e cila eshte pasqyruar ne tenderin e ri te ketij sherbimi.Deri tani nuk kemi shqetesime per kete sherbim.

-heqja e mbetjeve inerte nga pikat e grumbullimit dhe ambjente te tjera publike cdo dite.Ky eshte nje sherbim kryesor per mbajtjen paster te qytetit, prandaj edhe e kemi perfshire ne analizat e kosos se sherbimit te pastrimit.Eshte sherbim i domosdoshem per nje qytet te paster dhe mjedis te shendetshem, pasi mos heqja e mbetjeve te tilla ndot mjedisin perreth.Qytetaret tane nuk kane ankesa per kete sherbim, por kemi ne si drejtori e sherbimeve pasi ka shume qytetare qe i hedhin mbetjet inerte prane pikave te grumbullimit ose akoma me keq ne ambjente publike duke u bere shkak per ndotjen e mjedisit.Per kete sherbim ne kerkojme me shume mbeshtetjen nga Policia Bashkiake ne menyre qe te frenojme kete fenomen negative dhe te demshem per shendetin e qytetareve.

-Sistemimi i mbetjeve urbane ne vend depozitim e tyre ne ish Ferment Partizani.Ky sherbim ofrohet 65 dite ne vit dhe eshte shume i domosdoshem.Hedhja e mbetjeve urbane cdo dite krijon probleme ne vend depozitim prandaj jemi te detyruar ta ofrojme kete sherbim, jo vetem per te sistemuar mbetjet dhe per te bere mbulimin e tyre me dhe, por edhe per te hapur rrugen e mjeteve teknologjike per shkakrkimin pa problem te mbetjeve urbane. Duke pare problemet qe kemi me mjedisin ne vend depozitim , kushtet e reja per permiresimin e mjedisit, rrethimi e tij, mbrojtjen nga zjarri etj. kerkesa e jone ka qene qe te shtohen ditet e sherbimit ne vend depozitim.Por kjo do te varet edhe nga fondi financiar qe do te kemi ne dispozicion.Ditet e punes te planifikuara per sistemimin e mbetjeve urbane ne vend depozitim jane realizuar, bile jane bere edhe me shume dite. Duam te theksojme faktin se kemi perfunduar projektin per rehabilitimin e vend depozitim, ne bashkepunim me projektin zviceran, i cili kap vleren prej 603 807 euro me kontribut te projektit zviceran prej 80% dhe bashkise Kucove me kontribut 20% e vleres.

Ne njesine Kozare:

-grumbullim e transportim te mbetjeve urbane me mjet teknologjik e kontenire cdo dite.Per kete sherbim ne kemi ne dispozicion 95 konteniere metalike te shperndare ne te gjitha njesine, ne ato fshatra ku ofohet ky sherbim.Kemi gjithashtu ne dispozicion nje mjet teknologjik qe punon 104 dite ne vit, pra dy here ne jave per grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane per ne vend depozitim.Nuk ka patur problem me punen dhe volume e punimeve, por kemi patur kerkesa nga banoret te kesaj njesie per shtimin e sherbimit me kontenire te tjere.Deri tani jemi te kufizuar per shkak edhe te mungeses se infrastruktures rrugore ne zonat ku kerkohet shtimi i numrit te konteniereve.Shqetesime per kryerjen e ketij sherbimi kemi patur ne muajin nentor - dhjetor 2018.

-heqja e mbetjeve inerte nga pikat e grumbullimit dhe ambjente te tjera publike per 12 dite ne vit.Ky eshte nje sherbim kryesor per mbajtjen paster te njesise, prandaj edhe e kemi perfshire ne analizat e kosos se sherbimit te pastrimit. Por ditet qe ofrohet ky sherbim jane shume pak po te kemi parasysh qe cdo dite dalin shume mbetje inerte, kryesisht mbetje biologjike si barera, dege peme, bime te zarzavateve nga serrat si domate, specka, patllixhane etj. Eshte sherbim i domosdoshem per nje bashki te paster dhe mjedis te shendetshem, pasi mos heqja e mbetjeve te tilla ndot mjedisin perreth. Edhe per kete njesi kemi probeleme si drejtori e sherbimeve pasi ka shume qytetare qe i hedhin mbetjet inerte prane pikave te grumbullimit ose akoma me keq ne ambjente publike duke u bere shkak per ndotjen e mjedisit.Per kete sherbim ne kerkojme me shume mbeshtetjen nga Policia Bashkiake ne menyre qe te frenojme kete fenomen negative dhe te demshem per shendetin e banoreve.Ne tenderin e ardhshem kemi parashikuar qe te shtojme ditet e sherbimit per heqjen e mbetjeve inerte nga pikat e grumbullimit ne 104 dite ne vit.

Ne njesine Perondi:

- fshirja me fshese dore ne siperfaqen prej 8 000 m<sup>2</sup> per 104 dite ne vit.Kjo siperfaqe eshte e vogel vetem ne qender te ish komunes.Per tenderin e ardhshem parashikojme ta rritim kete siperfaqe ne rreth 30 000 m<sup>2</sup> dhe te shtojme me shume rruge qe fshihen me fshese dore deri ne 312 dite ne vit. Ky volum punimesh kryhet rregullisht dhe e vetmja ankese nga banoret per rritjen e siperfaqes se rrugeve qe fshihen me fshese dore.

-grumbullim e transportim te mbetjeve urbane me mjet teknologjik e kontenire cdo dite.Per kete sherbim ne kemi ne dispozicion 90 konteniere metalike te shperndare ne te gjitha njesine, ne ato fshatra ku ofohet ky sherbim.Kemi gjithashtu ne dispozicion nje mjet teknologjik qe punon 156 dite ne vit, pra tre here ne jave per grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane per ne vend depozitim.Nuk ka patur problem me punen dhe volume e punimeve, por kemi patur kerkesa nga banoret te kesaj njesie per shtimin e sherbimit me kontenire te tjere.Deri tani jemi te kufizuar per shkak edhe te mungeses se infrastruktures rrugore ne zonat ku kerkohet shtimi i numrit te konteniereve.

-larja e konteniereve metalike e cila parashikon 45 cope per 24 dite ne vit.Eshte nje ze sherbimi i nevojshem por qe eshte i pamjaftueshem per sasine qe parashikon.Ky ze eshte realizuar por per tenderin e ardhshem duhet te bejme korigjimin e duhur, jo vetem per rritjen e sasise se konteniereve qe duhet te lahen, por edhe ne shtimin e diteve te larjes deri ne 72 dite ne vit.

-lagia e rrugeve dhe shesheve me mjet teknologjik ne siperfaqen prej 8 000 m<sup>2</sup> per 26 dite ne vit. Eshte nje sherbim mjaft i kerkuar nga banoret se ka te beje direct me permiresimin e mjedisit, por siperfaqja eshte e vogel.Ne te ardhmen do te rritet kjo siperfaqe te pakten me rreth 30 000 m<sup>2</sup> si edhe ditet e sherbimit ne vit.Eshte rritur dhe do te jemi te detyruar qe te rritim siperfaqen e rrugeve e shesheve qe lagen per cdo dite.Deri tani nuk kemi shqetesime per kete sherbim.

-heqja e mbetjeve inerte nga pikat e grumbullimit dhe ambjente te tjera publike per 52 dite ne vit.Ky eshte nje sherbim kryesor per mbajtjen paster te njesise, prandaj edhe e kemi perfshire ne analizat e kosos se sherbimit te pastrimit. Por ditet qe ofrohet ky sherbim jane pak po te kemi parasysh qe cdo dite dalin



shume mbetje inerte, kryesisht mbetje biologjike si barera, dege peme, bime te zarzavateve nga serrat si domate, specka, patllixhane etj. Eshte sherbim i domosdoshem per nje bashki te paster dhe mjedis te shendetshem, pasi mos heqja e mbetjeve te tilla ndot mjedisin perreth. Edhe per kete njesi kemi probleme si drejtori e sherbimeve pasi ka shume qytetare qe i hedhin mbetjet inerte prane pikave te grumbullimit ose akoma me keq ne ambjente publike duke u bere shkak per ndotjen e mjedisit. Per kete sherbim ne kerkojme me shume mbeshtetjen nga Policia Bashkiake ne menyre qe te frenojme kete fenomen negative dhe te demshem per shendetin e banoreve. Ne tenderin e ardhshem paarshikojme qe te shtojme ditet e sherbimit per heqjen e mbetjeve inerte nga pikat e grumbullimit deri ne 104 dite ne vit.

Duhet te theksojme faktin se per te gjitha volumet e punimeve te zerave te sherbimit te pastrimit, mban pergjegjesi edhe supervizori i sherbimeve publike i bashkise, i cili kontrollon cdo dite kryerjen e tyre dhe ne fund te cdo muaji mban proces verbal me sipermarresin e sherbimit te pastrimit per kryerjen e volumeve te punimeve per cdo muaj.

#### **“Plani për Rehabilitimin” e vend depozitimit të mbetjeve urbane:**

Në zbatim të ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të VKM Nr.389, datë 27.06.2018 “Për disa shtesa e ndryshime në VKM Nr.452, datë 11.07.2012 “Për vend depozitimet e mbetjeve urbane”, drejtoria e shërbimeve publike ka punuar me përgjegjësi për të plotësuar këtë detyrim ligjor dhe ka hartuar një “Plan Rehabilitimi” për vend depozitimin e mbetjeve urbane në ish Fermën “Partizani”, sot fshati Rreth Tapi, rreth 4 km larg qytetit Kuçovë.

Në kuadrin e bashkëpunimit midis Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë Zvicerane, që prej muajit shtator 2018 në Qarkun e Beratit funksionon një projekt për menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta urbane, i cili parashikon hartimin e Strategjisë dhe Planit Rajonal për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane dhe rehabilitimin e vend depozitimeve të pesë bashkive të Qarkut Berat, hartimin e Planeve Bashkiake për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane për çdo bashki dhe që financohet nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike “SECO”.

Siç e theksuam më lart, drejtoria e shërbimeve në bashkëpunim me projektin zviceran ka hartuar planin për rehabilitimin e vend depozitimit në fshatin Rreth Tapi, rreth 4 km larg qytetit të Kuçovës. Besojmë dhe po punojmë çdo ditë që ky plan do të realizohet me sukses dhe bashkia Kuçovë do të ketë një landfill të mirë, me kushtet dhe kërkesat e kohës, sipas përcaktimeve të VKM Nr.389, datë 27.06.2018 “Për disa shtesa e ndryshime në VKM Nr.452, datë 11.07.2012 “Për vend depozitimet e mbetjeve urbane”, një vend depozitimi që nuk do të ketë më probleme me asgjësimin e mbetjeve të ngurta urbane dhe me ndotjen e mjedisit për banorët e këtij fshati dhe mjedisin përreth.

Sipas llogaritjeve të bëra investimi në këtë vend depozitim do të jetë **603 807 Euro**, ku përveç shume punimeve të tjera parashikohet edhe rrethimi i plotë i këtij vend depozitimi me sipërfaqe rreth 28 000 m<sup>2</sup>. Sipas kushtit që kanë nënshkruar të dy qeveritë tona kontributi i bashkisë Kuçovë do të jetë 20% e kësaj shume, pra rreth **120 761 Euro**. Por për rehabilitimin e këtij vend depozitimi kërkohet që edhe rruga që lidh qendrën e fshatit Rreth Tapi (ish Ferma “Partizani”) deri në hyrje të vend depozitimit, e cila është rreth 660 ml të rikonstruohet për qarkullimin normal të mjeteve të rënda teknologjike dhe automjeteve të tjera, jo vetëm të shërbimit të pastrimit por edhe të banorëve të zonës. Këtë investim për rehabilitimin e rrugës e ka marrë përsipër bashkia jonë, si pjesë e kontributit të saj në projektin për rehabilitimin e vend depozitimit, pasi më parë ka rënë dakort projekti zviceran.

Sipas projektit të bërë nga Drejtoria e Urbanistikës rikonstruksioni i rrugës nga qendra e fshatit deri në hyrje të vend depozitimit me gjatësi 660 ml është rreth 12 361 644 lekë. Kjo parashikon një gjerësi prej 4,5 m dhe bankinë nga 0,5 m nga të dy anët, hapje kanali nga të dy anët dhe vendosjen e tubove Ø500 cm prej betoni për sistemimin e ujrave të shiut, shtresë çakulli 20 cm, shtresë stabilizanti 10 cm, shtresë binderi (asfalto beton) 6 cm.

Duke qenë se bashkia jonë nuk ka gjendje të mirë financiare dhe nuk mund të përballojë rikonstruksionin e kësaj rruge bashkia i është drejtuar me shkresë zyrtare kompanisë “Bankers” ltd Fier për të bashkëfinancuar rikonstruksionin e kësaj rruge. Drejtuesit e “Bankers” kanë rënë dakort dhe presim një takim të tyre me kryetarin e bashkisë për të përfunduar marrëveshjen.

Ne jemi duke punuar në këtë rrugë me pastrimin e kanaleve në të dy anët e saj, kemi vendosur edhe tubot prej betoni Ø500 cm dhe jemi duke bërë skarifikimin e sipërfaqes së rrugës, në menyre që t’ia bëjmë gati kompanisë “Bankers” ltd Fier për të hedhur shtresat e çakullit, të stabilizantit e më pas shtresën e asfaltit.

Nga ana tjetër bashkia detyrohet që të vazhdojë punën ne vend depozitimin e rehabilituar nga projekti zviceran, pasi ata të kenë përfunduar projektin e plotë. Për këtë ne kemi miratuar edhe fondin prej 3 479 550 lekë me miratimin e buxhetit të vitit 2019 (një kopje të kësaj analize kostoje ta kam dërguar) dhe kështu kemi plotësuar të gjitha detyrimet që kemi ndaj projektit zviceran, detyrime që lindin nga marrëveshja e dy qeverive tona për këtë projekt.

## **2. Sherbimi i Dekorit.**

### **Qyteti Kucove:**

| <b>Nr.</b> | <b>Emertimi i punimeve</b> | <b>Njesia</b>  | <b>Sasia</b> | <b>Cmimi</b> | <b>Vlera</b> |
|------------|----------------------------|----------------|--------------|--------------|--------------|
| 1.         | F.V banderola              | cope           | 27           | 17 829       | 481 383      |
| 2.         | F.V flamuj                 | cope           | 40           | 2 566        | 102 640      |
| 3.         | F.V vijezime per automjete | ml             | 2 000        | 252          | 504 000      |
| 4.         | F.V vijezime per kembesore | m <sup>2</sup> | 300          | 337          | 101 100      |



|    |                               |      |    |        |                  |
|----|-------------------------------|------|----|--------|------------------|
| 5. | F.V tabela qarkullimit rrugor | cope | 25 | 10 592 | 264 800          |
| 6. | F.V riparime te lapidareve    | cope | 6  | 20 000 | 120 000          |
|    | <b>Shuma</b>                  |      |    |        | <b>1 573 923</b> |

Edhe per sherbimin e dekorit drejtoria e sherbimeve publike eshte angazhuar qe te kryhet sa me mire, me cilesi dhe ne kohen e duhur ne rast te festive zyrtare dhe fetare. Ndjeshmeria e qytetareve per kete sherbim eshte e madhe prandaj edhe ne jemi treguar te kujdeshshem ne realizimin me cilesi te ketij sherbimi. Nje informacion me te detajuar per kete sherbim eshte bere nga drejtoria e sherbimeve publike te cilin e keni ne dispozicion ne mbledhjen e muajit janar 2019.

Zerat e punimeve dhe volumet per cdo ze jane realizuar gjate vitit 2018 dhe me konkretisht:

-f.v e banderolave me dy faqe per festat zyrtare dhe fetare gjithsej 27 cope ne vit. Per kete jane parashikuar rreth 9 festa fetare dhe zyrtare ku banderolat vendosen ne vendet e caktuara nga bashkia ne kontarten e lidhur midis paleve. Ky ze eshte realizuar ne sasine e caktuar ne analizen perkatese te kostos, per periudhen 6 mujore ku eshte realizuar tenderi I ri per kete sherbim. Shqetesim kemi kerkesat per rritjen e numrit te banderolave, kryesisht nga organizatat e veteraneve dhe familjeve te deshmoreve, te komuniteteve fetare dhe te OJF-ve.

-fv flamuj per rastet e festave zyrtare gjithsej 40 cope. Edhe ky ze eshte realizuar ne sasine e percaktuar, bile ne cdo flamur behet edhe shqiponja dy krenare. Flamujt vendosen ne te gjitha rastet e festive zyrtare, ne vende te dukshme dhe me efekt visual te qytetaret. Deri tani nuk kemi verejtje apo ankesa nga qytetaret.

-f.v vijeze per automjete ne rruget e qytetit, gjithsej 2000 ml. Eshte nje ze shume i rendesishem i dekorit, vecanrisht per rregullimin e levizjes se automjeteve ne rruget e qytetit. Problem eshte kerkesa e madhe e drejtuesve te automjeteve per rritjen e sasise se vijezeve ne rruge, te vend parkimeve. Dëshira e jone eshte qe te bejme rritjen e sasise se vijezeve ne rruge, por kjo do te varet nga fondi qe do te kemi ne dispozicion. Edhe ky ze sherbimi eshte realizuar ne sasise e percaktuar.

-f.v vijeze per kembesore ne rruget dhe kryqezimet kryesore te qytetit, gjithsej 300 m<sup>2</sup>. Eshte nje ze shume i rendesishem i dekorit, vecanrisht per rregullimin e levizjes se qytetareve ne rruget e qytetit dhe kryqezimet kryesore. Problem eshte kerkesa e madhe e qytetareve dhe e institucioneve arsimore si shkolla e kopshte per rritjen e sasise se vijezeve ne rruge per kembesore. Dëshira e jone eshte qe te bejme rritjen e sasise se vijezeve ne rruge per kembesore, por kjo do te varet nga fondi qe do te kemi ne dispozicion. Edhe ky ze sherbimi eshte realizuar ne sasise e percaktuar.

-f.v e tabelave te qarkullimit rrugor ne rruget e sheshet e qytetit, gjithsej 25 cope. Vendosja e tabelave eshte nje ze i rendesishem dhe shume i kerkuar nga drejtuesit e automjeteve dhe Policia e Qarkullimit Rrugor. Per dy vitet e fundit ku jane bere rikonstruksione te rrugeve brenda qytetit eshte shtuar shume kerkesa per tabela te qarkullimit rrugor. Ne e dime qe kerkesat jane te medha por ne tenderin e ardheshem cdo gje do te varet nga fondi financiar qe do te kemi ne dispozicion. Problem per drejtorine e sherbimeve publike mbetet vjedhja e tabelave te qarkullimit rrugor, apo demtimi i tyre nga persona te papergjegjshem, problem qe ende nuk kemi mundur ta zgjidhim edhe pse vazhdimisht kemi kerkuar ndihmen e Policise se Qarkullimit Rrugor dhe te Policise Bashkiake.

-f.v riparime te lapidareve gjithsej 6 lapidare e basoreliefe. Te gjitha lapidaret e parashikuar per riparime si lapidari kushtuar clirimit te Kucove, te kryqezimi ne hyrje; lapidari kushtuar greves se naftetareve te Kucoves, te sheshi "11 janari"; lapidari kushtuar deshmorit Gaq Karakashi, te ofcina e QPN, basoreliefi kushtuar naftetareve, te shkallet e Muzeut, lapidari ne Perondi dhe ne Velagosht, si dhe lapidari ne Vodez njesia Lumas, te cilet jane riparuar cdo vit, perpara dites perkujtimore dhe jane lyer me boje sipas rastit. Kerkesa kemi patur, vecanrisht nga organizatat e veteraneve dhe familjeve te deshmoreve qe te rritet numri i lapidareve per mirembajtje e riparime, por kjo do te varet nga fondi financiar qe do te kemi ne dispozicion.

Theksojme faktin se per te gjitha volumet e punimeve te zerave te sherbimit te dekorit, mban pergjegjesi edhe supervizori i sherbimeve publike i bashkise, i cili kontrollon cdo dite kryerjen e tyre dhe ne fund te cdo muaji mban proces verbal me sipermarresin e sherbimit te dekorit per kryerjen e volumeve te punimeve per cdo muaj.

### 3. Sherbimi i Mirembajtjes se Varrezave Publike.

#### Qyteti Kucove, Njesia Kozare, Lumas dhe Perondi.

| Nr. | Analiza | Emertimi punimeve   | Njesi a        | Sasia/vjetore | Çmimi | Shuma     |
|-----|---------|---|----------------|---------------|-------|-----------|
| 1   | An-1    | Pastrim rruge e sheshe te betonit ne varreza.                       | m <sup>2</sup> | 918,720       | 1.66  | 1,525,075 |
| 2   | 3.1     | Prerje bari, kositje, pastrim e mirembajtje peme+shkurre.dekorative | m <sup>2</sup> | 125,760       | 10.5  | 1,320,480 |
| 3   | An-3    | Riparim shtrese betoni, rruge dhe sheshe.                           | m <sup>2</sup> | 530           | 403   | 213,590   |
| 4   | 2.291/1 | Riparim bordura monolite 15x35                                      | ml             | 20            | 751   | 15,020    |
| 5   | An -5   | Riparim muri rrethues me tulla                                      | ml             | 5             | 3160  | 15,800    |
| 6   | An -6   | Riparim muri rrethues me blloqe                                     | ml             | 5             | 858   | 4,290     |
| 7   | An -7   | Riparim muri rrethues me gure                                       | ml             | 2             | 2069  | 4,138     |
| 8   | An -8   | Riparim muri rrethues me rrjet gabion pa themelin                   | ml             | 60            | 1981  | 118,860   |
| 9   | An -9   | Riparim muri rrethues me rrjet gabion me themel                     | ml             | 6             | 3691  | 22,146    |
| 10  | 2.121   | Riparim brezi (korniza) betoni mbi mur tulle, blloqe , guri.        | m <sup>3</sup> | 1             | 12423 | 12,423    |
| 11  | 2.401   | Lyerje me boje vaji te konstruksioneve metalike                     | m <sup>2</sup> | 2             | 428   | 856       |
| 12  | 2.399   | Sherbetisje e bojatisje me gelqere                                  | m <sup>2</sup> | 80            | 44    | 3,520     |
| 13  | 2.390/1 | Riparim konstruksione metalike, portave hyrje - dalje               | m <sup>2</sup> | 5             | 6803  | 29,015    |
| 14  | An-14   | Riparim qivuri, nga levizja e tokes                                 | cope           | 5             | 2705  | 13,525    |
| 15  | An-15   | Zevendesim pllake mermeri e demtuar ne qivure                       | m <sup>2</sup> | 8             | 7234  | 57,872    |

|    |       |   |                |    |       |                  |
|----|-------|---|----------------|----|-------|------------------|
| 16 | An-16 | Zevendesim pllake graniti e demtuar ne qivure | m <sup>2</sup> | 8  | 11126 | 89,008           |
| 17 | An-17 | Zevendesim pllake granili e demtuar ne qivure | m <sup>2</sup> | 2  | 1258  | 2,516            |
| 18 | An-18 | N/Shtrese zhavorri 10 cm                      | m <sup>2</sup> | 80 | 135   | 10,800           |
|    |       | <b>Shuma e punimeve te drejteperdrejta</b>    |                |    |       | <b>3,458,934</b> |
|    |       | Fondi Rezerve 5%                              |                |    |       | 172,947          |
|    |       | <b>Shuma</b>                                  |                |    |       | <b>3,631,881</b> |
|    |       | TVSH-20%                                      |                |    |       | 726,376          |
|    |       | <b>Shuma Totale</b>                           |                |    |       | <b>4,358,257</b> |

Sherbimi i mirembajtjes se varrezave publike eshte nje sherbim public i cili ofrohet ne te gjithë territorin e bashkise se re, edhe ne ato fshatra ku dikur nuk kishte asnje lloj sherbimi nga ish komunat.Me mundesite financiare qe kemi patur ne dispozicion ne kemi arritur ta ofrojme kete sherbim ne te gjithë territorin, me volumet e parashikuara ne preventivin e mesiperm, duke qene te vetedijshem se ky fond i dhene deri tani nuk i ploteson te gjitha kushtet e kerkuara.Por megjithate ne kemi realizuar mirembajtjen e varrezave publike pothuajse ne te gjitha fshatrat e bashkise se re ne zerat e volumet si me poshte:

-pastrim rruge e sheshe te betonit ne varrezat publike, gjithsej 918 720 m<sup>2</sup>.Kjo sasi eshte parashikuar ne rreth 32 varreza publike, duke patur parasysh siperfaqet e tyre dhe nevojen per kete ze sherbimi.Ky ze eshte realizuar ne sasine e parashikuar ne kete analize kostoje.

-Prerje bari,kositje,pastrim e mirembajtje peme+shkurre dekorative, gjithsej 125 760 m<sup>2</sup>. Edhe kjo sasi eshte parashikuar ne rreth 32 varreza publike, duke patur parasysh siperfaqet e tyre dhe nevojen per kete ze sherbimi.Ky ze eshte realizuar ne sasine e parashikuar ne kete analize kostoje.

-Riparim shtrese betoni,rruge dhe sheshe, gjithsej 530 m<sup>2</sup>.Po te kemi parasysh numrin e madh te varrezave publike qe iu sherbejme dhe siperfaqen e seciles prej tyre, kjo sasi siperfaqeje eshte e vogel dhe nevojat jane shume here me te medha.Por ne kete pike jemi treguar shume racionale duke betonuar nje sasi te caktuar per shumicen prej varrezave publike, ne menyre qe te rregullojme sa te jete e mundur infrastrukturen ne cdo parcele te varrezave publike dhe ato te kene nje pamje me dinjitoze.Ky ze eshte realizuar ne sasine e parashikuar ne kete analize kostoje.

-Riparim bordura monolite 15x35, gjithsej 20 ml.Kjo sasi eshte realizuar pothuajse ne varrezat publike te Kucoves pasi ketu prej kohesh kemi nje infrastrukture me te mire brenda parceles se varrezave publike, me nje sere rrugicash qe kane bordure anesore, te cilat lidhin parcelat e varreve me njera tjetren.

-Riparim muri rrethues me tulla, blloqe e gure, gjithsej 12 ml.Edhe kjo sasi eshte realizuar pothuajse ne varrezat publike te Kucoves pasi ketu prej kohesh eshte ndertuar mur rrethues per varrezat publike, nje pjese me mur tulle, nje pjese me blloqe dhe nje pjese me mur guri.

-Riparim muri rrethues me rrjet gabion pa themelin dhe me themelin, gjithsej 66 ml.Kjo sasi eshte realizuar ne nje pjese te varrezave publike, kryesisht ne fshatrat e njesise Kozare, Lumas dhe Perondi ku kemi varrezat te rrethuara me rrjet gabion.Nevodat jane shume here me te medha per kete ze, sepse shumica e varrezave publike ne fshatrat e bashkise se re jane te rrethuara me rrjet gabion.

-Lyerje me boje vaji te konstruksioneve metalike, gjithsej 2 m<sup>2</sup>.Kjo sasi eshte planifikuar per lyerjen e portave te hyrjes se varrezave publike ne qytet dhe ne fshatrat e njesise Kozare, Lumas dhe Perondi. Sasia e planifikuar per kete ze eshte shume e vogel dhe nuk del per nje varreze, kur ne kemi 32 varreza publike ne te gjithë territorin e bashkise se re.

-Sherbetisje e bojatisje me gelqere, gjithsej 80 m<sup>2</sup> e planifikuar kryesisht ne varrezat e Kucoves dhe pjeserisht ne varreat e Kozares e Perondise, aty ku ka mur rrethues ne varrezat publike.Edhe ky ze eshte realizuar ne sasine e planifikuar ne analizen perkatese te kosos.

-Riparim konstruksione metalike, portave hyrje - dalje, gjithsej 5 m<sup>2</sup>.Kjo sasi eshte planifikuar per varrezat publike, te cilat kane porta hyrje - dalje dhe qe here pas here kane nevoje per riparime te elementeve te tyre nga demtime te mundshme.Kjo sasi eshte realizuar sipas planifikimit ne analizat e kosos, por qe eshte e pamjaftueshme per te gjitha varrezat e bashkise.

-Riparim qivuri,nga levizja e tokes, gjithsej 5 qivure.Kjo sasi qivuresh eshte e vogel ne krahasim me numrin e madh te qivureve te ndertuara ne te gjitha varrezat publike te bashkise se re.Nga rreshqitjet e tokes na ndodhin shpesh demitime te qivureve apo elemnteve te tyre dhe ne detyrohemi ti riparojme ato.Sipas planifikimit kjo sasi eshte realizuar plotesisht.

-Zevendesim pllake mermeri e demtuar ne qivure, pllake graniti dhe pllake granili ne qivure, gjithsej 18 m<sup>2</sup>.Kjo sasi eshte planifikuar per zevendesim ne qivuret perfundimtare, te cilat mund tu demtohen sipas rastit pllakat prej mermeri, graniti ose prej granili.Nevodat per kete sherbim jane shume here me te medha, por kaq kane qene mundesite tona financiare.Por sidoqofte kjo sasi eshte realizuar sipas analizes se kosos dhe ne ato qivure qe e kane patur te domosdoshem riparimin e pllakave.

-Nen shtrese zhavorri 10 cm, gjithsej 80 m<sup>2</sup>. Kjo sasi eshte planifikuar per rrugicat ose rruget kryesore te varrezave publike, e cila eshte perdorur sipas rasteve ne ato varreza publike qe kane patur me shume probleme me infrastrukturen, por edhe kjo sasi eshte e pamjaftueshme po te kemi parasysh numrin e madh te varrezave dhe siperfaqen e madhe te tyre .

Theksojme faktin se per te gjitha volumet e punimeve te zerave te sherbimit te mirembajtjes se varrezave publike, mban pergjegjesi edhe supervizori i sherbimeve publike i bashkise, i cili kontrollon cdo dite kryerjen e tyre dhe ne fund te cdo muaji mban proces verbal me sipermarresin e sherbimit te mirembajtjes e varrezave publike, per kryerjen e volumeve te punimeve per cdo muaj.

### **-MBROJTJA E MJEDISIT:**

Drejtoria e Mjedisit e bazon punen e saj ne baze te: Ligji nr.139,dt.17.12.2015 "Per vetqeverisjen vendore", ligjit 10431 "Per mbrojtjen e Mjedisit" ligjit 10448 date 14.07.2011 "Per Lejet e mjedisit" Ligji nr.10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar te mbetjeve", Ligji nr.27/2016, datë

17.03.2016 "Per menaxhimin e kimikateve », Ligji 10097 date 19.03 2009 per nje shtese ne ligjin nr.8405, Dt.17.9.1998 "Per urbanistiken" te ndryshuar,Ligjit 9774 date 12 .07.2007 "Per vleresimin dhe administrimin e zhurmes ne mjedis" Ligjin nr.162/2014 dt.04.12.2014 "Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja, Ligjit 10440 date 07.07.2011 "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis"vendimi nr. 103, datë 31.3.2002 "Per monitorimin e mjedisit ne Republiken e Shqiperise", vendimi nr.34, date 28..01.2002. "Per miratimin e Planit Kombetar te Veprimit per Mjedisin", *Udhezimi nr.419 dt.25.06.2014 "Per miratimin e kerkesave per leje mjedisore tipi A,B,C.kushtet e dhenies se tyre,transferimi i lejeve nga nje subjekt ne tjetrin..."* ligjit nr.10465 "Per sherbimin Veterinar ne Republikene Shqiperise" i ndryshuar,ligjit 87/2012" Per miratimin e aktit normativ nr 4 dt 16.08.2012, per percaktimin e rregullave per therjen e kafsheve dhe tregetimin e mishit te tyre", vendimit nr.230/03/2013si dhe ne baze te akteve te tjera nenligjore perkatese ,rregulloreve, urdheresave, si dhe detyrave te tjera specifike.

### **Problemet mjedisore**

Ndiqen nga sektori i Mjedisit i cili ne baze te planeve te punes mujore dhe tematikes vjetore ka realizuar detyrat e meposhteme:

**1.**Detyra kryesore e ketij sektori eshte listimi i subjekteve qe ndikojne ne mjedis duke bere presionin e duhur qe keto subjekte ti nenshrohen proçedurave te marrjes se lejes mjedisore apo vleresimit te ndikimit ne mjedis sipas rastit konkret.Ne kete aspekt ne kemi nje bashkepunim te mire me ARM dhe ISHMP Berat qe eshte struktura qe kryen inspektimet duke i detyruar subjektet qe te aplikojne per leje mjedisore sipas tipeve A,B,C ku kjo e fundit fillon me proçedure te pare nga pushteti lokal. Per kete vit jane nxjerr respektivisht 17 leje mjedisore te tipit C dhe riaplikime. Aplikimi fillon prane sporteleve te QKB, me pas tek QKL dhe sipas fushave perkatese te licensave orjentohe drejt ministrive per tu shqyrtuar sipas vkm 419 ne rastin e problematikave mjedisore. Gjate ketij viti ne bashkepunim me ARM Berat dhe Drejtorine Rajonale te Tatimeve u evidentuan te gjitha subjektet e rregjistruara prane ketyre strukturave dhe prej tyre u selektuan ato subjekte qe duhet ti nenshrohen aplikimit per leje mjedisore.

Pas paisjes me leje mjedisore keto subjekte ndiqen ne vazhdimesi per zbatimin e kushteve te lejes ku serish ne bashkepunim me ISHMP sipas problemeve te hasura ne mbajme proçes verbalet e konstatimit dhe per çdo rast informohet Inspektoriati per shkeljet e hasura.

Nje rast i tille ka te beje me subjektin OROLAT qe ka filluar te anashkaloje kushtet e lejes mjedisore me aktivitet ne fushen e perpunimit te bulmetit. Per problemet qe ka sjell dhe ndotjen qe ka shkaktuar here pas here me shkarkimet e ujrave teknologjik ne ambiente te hapura apo per shkarkimet ne ajer te tymrave nga paisjet qe perdore per ngrohje (kaldaja me bersi ulliri) ne bashkepunim me ISHMP ky subjekt eshte gjobitur me 300 mije leke per here te pare. Kemi patur korrespondenca te shumta me ISHMP Berat per kete subjekt por ne serish jemi te pakenaqur me adresimin dhe zgjidhjen pozitive te problemit.

**2.**Problemi i mbetjeve spitalore ka qene nje tjetër detyre e ndjekur nga ana jone ku ne bashkepunim me DSHP-ne Kuçove i kemi dhene nje zgjidhje ligjore ketij problemi duke i grumbulluar dhe perpunuar sipas ligjit perkates.

Per kete jane lidhur kontratat perkatese me te gjitha qendrat shendetesore me subjektin **MEDI-TEL"sh.p.k me administrator z.Anastas Peçini** me adrese; Mezes Komuna Kashar Tirane me leje mjedisore nr.vendimi 5 date 14.04.2009. Spitali dhe Poliklinika Qendrore kane nje kontrate tjetër me subjektin **EURO-TEAM** qe funksionojne rregullisht dhe ne here pas here bejme kontrollat per te pare se si funksionon ky proçes duke dokumentuar dhe fotografuar.

Per çdo sasi te dorezuar nga qendrat shendetesore, spitale, poliklinika, klinikat dentare shenohet ne menyre korrekte sasia e mbetjeve dhe lloji i tyre. Me poshte ne po japim nje tablele te ketyre mbetjeve per vitin 2018 te ndare ne tre mujor dhe ne total.

| Institucionet     | Tre mujori i pare (kg) | Tre mujori i dyte (kg) | Tremujori i trete (kg) | Tre mujori i katert (kg) | Vjetore (kg)   |
|-------------------|------------------------|------------------------|------------------------|--------------------------|----------------|
| Sherbimi Spitalor | 290                    | 330                    | 400                    | 375                      | 1395           |
| DSHP Kuçove       | 4                      | 14                     | 19                     | 19                       | 56             |
| QSH Kuçove        | 30                     | 27                     | 54                     | 87,4                     | 198,4          |
| QSH Kozare        | 20                     | 19.6                   | 22                     | 22                       | 83.6           |
| QSH Perondi       | 9.5                    | 12                     | 23.380                 | 16                       | 60.88          |
| <b>Totali</b>     | <b>353.5</b>           | <b>402.6</b>           | <b>518.38</b>          | <b>519.4</b>             | <b>1793.88</b> |

Ne lidhje me llojet e mbetjeve spitalore te gjeneruara ne territorin tone jane si me poshte:

**Mbetjet infektuese:** Ketu perfshihen agjentet patogjen si: bakteret, viruset, parazitet ose kerpudhat dhe perfshijne kulturat nga puna ne laborator, mbeturinat nga nderhyrjet kirurgjikale dhe autopsite, mbeturinat nga pacientet e infektuar, materialet apo pajisjet (qe jane per t'u hedhur) ne kontakt me keta paciente, me kafshe te infektuara, si dhe materialet dhe pajisjet e mjekeve dhe te personelit shendetesor tjetër, qe kane qene ne kontakt me paciente te infektuar.

**Mbetjet patologjike:** Perfshijne indet, organet, pjese te trupit, plaçentat, gjakun dhe lengjet e tjera te organizmit te njeriut.

**Mbetjet farmaceutike.** Përfshijne produktet farmaceutike të skaduara ose të përdorshme, produktet farmaceutike të kontaminuara nga rena/rrezimi i pertokës, barnat e tepërta, vaksinat ose serumet dhe sendet e hedhura të përdorura gjatë trajtimit të barnave, të tilla si: shishe, kuti, dorëza, maska, tuba ose shishe.

**Mbetjet radioaktive.** Përfshijne mbeturinat e lengeta; të ngurta dhe të gazta, të ndotura me lëndë radioaktive, të prodhuara nga analizat “in vivo” e organeve të ndryshme për qëllime diagnostike dhe terapeutike.

**Mbetjet e parrezikshme.** Përfshijne letrat, sendet prej qelqi, plastike, kartonet, ambalazhet, mbeturinat ushqimore, mbeturinat druri dhe ndërtime.

3. Në bashkëpunim me DSHP Kuçovë janë organizuar plane tematike të përbashkëta sipas periudhës të ndryshme ku veçanërisht spikatin ato të periudhës së verës. Kemi patur gjithashtu një korrespondencë të vazhdueshme mujore për të gjithë planin e monitorimit të ujit të pijshëm për parametrat fiziko-kimik dhe bakteriologjik ku duhet të theksohet se ka patur raste të ndotjeve të natyrave të ndryshme por është nderhyrë menjëherë nga ndermarrja përkatëse duke riparuar defektet e ndryshme në sistemin e shpërndarjes ku duhet theksuar se është tejte e amortizuar çka rrit mundësinë për ndotje bakteriologjike të ujit sidomos në zonat periferike ku problemi është mjaft evident që shoqërohet me mungesën e ujit të pijshëm. Here pas here gjatë periudhës së verës si dhe një infrastrukturë tepër primitive të administrimit të ujërave të zeza dhe infrastrukturës rrugore në përgjithësi duke qenë një nga shqetësimet kryesore të banorëve të këtyre zonave.

Në bazë të këtyre analizave arrijmë në konkluzionin se gjatë gjithë vitit janë kryer :

| Lloji i analizës | Qytet (vjetore) | Fshat (vjetore) |
|------------------|-----------------|-----------------|
| Fiziko-Kimike    | 19 708          | 3 483           |
| Bakteriologjike  | 4 423           | 539             |
| Klori Residual   | 6 173           | 539             |

4. Janë ndjekur me përparësi problemet e gumbullimit, largimit dhe përpunimit të mbetjeve urbane, në bazë të kontrolleve të përjavshme të kryera nga specialistët e mjedisit. Terheqja e mbetjeve urbane bëhet në mënyrë të rregullt në orët e para të mëngjesit. Në qytet janë vendosur 240 kontenerë me vëllim 1100m<sup>3</sup>, dezinfektimi i kontenerëve bëhet në mënyrë të rregullt nga firma sipermarese. Megjithatë situatën e rënduar në vendgrumbullimin e mbetjeve në Reth Tapi në shpërndarje që ky problem të marrë zgjidhje se shpejti në kuadër të projektit rajonal Zvicërian. Janë ndjekur problemet e ndotjes akustike në bashkëpunim me DSHP Kuçovë dhe Policinë Bashkiake për sigurimin dhe respektimin e normave dhe orareve të përcaktuara.

5. Është ndjekur problemi i fushës së shkarkimit të kontrolluar të mbeturinave urbane të qytetit ku vazhdon një situatë jo normale qoftë në drejtim të kushteve sanitare por dhe të ndezjeve të here pas here duke shkaktuar ndotje në atmosferë. Po shikohet mundësia e një menaxhimi më të mirë të mbetjeve duke synuar ndarjen që në origjinë të mbetjeve urbane. Shqetësues është situata e ndezjes së këtyre mbetjeve gjatë periudhës së verës duke shkaktuar ndotje në ajër. Në këtë drejtim në gjykojmë se vendosja e një roje nga ana e subjektit të pastrimit si dhe rrethimi i objektit do të reduktojnë këtë fenomen negativ për mjedisin dhe komunitetin në përgjithësi. Nga ana tjetër mungesa e shërbimit të pastrimit në disa qendra të tjera të ish-njësive vendore po sjellë pasoja në krijimin e pikave të reja të grumbullimit të mbetjeve urbane duke shkaktuar ndotje të ambientit në rrugë, perrenj apo lumenj. Është nderhyrë here pas here në këtë drejtim por nuk është zgjidhje pastrimi i momentit pasi kjo kerkon një zgjidhje afatgjatë nëpërmjet vendosjes së kontejnerëve dhe shtrirjes së shërbimit të pastrimit në këtë zonë. nderhyrje të tilla kanë qenë aksionet e organizuara në javën boterore të tokës në 16-22 Prill si dhe javës boterore të pastrimit të qytetve nga mbetjet urbane në 22 Nëntor ku në bashkëpunim me strukturat e bashkisë u hartuan plane veprimi konkrete në kordinim të plotë me prefekturën.

6. Në lidhje me edukimin mjedisor një aspekt i punës ka qenë sensibilizimi i opinionit qytetar për mbrojtjen e mjedisit. Gjatë këtij viti janë përgatitur flete palosje, si dhe disa mini projekte në fushën e edukimit mjedisor dhe mbeten për tu realizuar në vazhdim (sipas planit).

7. Një nga detyrat me të cilat meremi si drejtori është dhe rifreskimi i Raportit Mjedisor vjetor të hartuar me parë. Për elemente të ndryshme të këtij raporti sipas dhe gjendjes konkrete të mjedisit në terren do të kerkohet monitorim konkret nga strukturat e specializuara kryesisht nga ISHP Tirane apo ndonjë studio private. Studimi i fundit është kryer në vitin 2015. Kjo kerkon mbështetje financiare. Gjithashtu është e domosdoshme zbatimi i Planit të Veprimit për mbrojtjen e Mjedisit dhe kryesisht Plan i Veprimit për cilesinë e Ajrit në mjedis. Baza kryesore e këtyre të dhënave tashmë është pasuri në dispozicion VSM si pjesë e Planit të Përgjithshëm Vendor të hartuar me mbështetjen e CO Plan dhe që nga ana jone po specifikohen problemet sipas objektivave konkrete siç është rasti i evidentimit të ndotjes së tokës nga hidrokarburet si pasojë e veprimtarisë së industrisë nxjerrëse të naftës. Ky është një proces që ka nisur nga ana jone por nuk ka përfunduar ende pasi është një proces voluminoz dhe kerkon një logjistike mbështetëse.

8. Në lidhje me ankesat e qytetarëve, sektori ynë ka ndjekur me përpikëri çdo shqetësim të qytetarëve në kohën e duhur. Sipas rasteve këto ankesa janë ndjekur në bashkëpunim dhe me sektorin e veterinarisë si



dhe me Policine Bashkiake (gjithsej kemi ndjekur rreth 18 raste). Te gjitha rastet jane ezauruar konform ligjeve ne fuqi. Shqetesimet kane te bejne me natyra te ndryshme por kryesisht ato fokusohen ne probleme higjeno-sanitare ne mbarshtrimin e kafsheve, shpendeve, objekteve ku ato mbahen ku pervec rasteve te tilla ne zonen urbane ne qytet tashme po na shfaqen edhe ne zona rurale. Rastet jane shqyrtuar ne menyre konkrete dhe ne pergjithesi jane zgjidhur duke minimizuar efektet e ndotjes se mjedisit, por ka ende raste te tjera qe problemet mbeten te pa zgjidhura. Nga ana tjeter keto jane probleme qe nuk kane nje zgjidhje specifike ligjore por ne jemi munduar ti trajtojme ne baze te rregullores se KB Nr 57 date 29.09 .2013 “Per mbrojtjen e mjedisit urban nga ndotja”. Ne kete kuader ne mendojme qe kjo rregullore ka nevojte te permiresohet duke fokusuar te gjitha problemet qe shqetesojne komunitetin duke trajtuar problemin ne sensin e bashkejeteses ne komunitet ku do te kerkohet angazhim i te gjitha strukturave te bashkise per adresimin e problemeve te ndryshme ekstraligjore. Ka praktika te mira ne kete drejtim siç eshte Bashkia e Tiranës apo ndonje tjeter qe duhet pare.

### **Kontrolli i Ushqimit dhe Sherbimi Veterinar**

Permbushja e objektivit persigurine ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit ka ne thelb disa hallka te rendesishme qe jane:

1. Siguria Veterinare qe vezhgohet nga sherbimi veterinar i Bashkise
2. Siguria e standartit, cilesise dhe kushteve sanitaro-veterinare qe vezhgohet nga Inspektoriati AKU.

Bashkepunimi midis ketyre hallkave perben nje proces te rendesishem duke siguruar konsumatorin ne te gjitha kompleksitetin qe ka çdo hallke e zinxhirit ushqimor me vete.

Persa i perket sigurise veterinare qe mbulohet nga sherbimi veterinar i Bashkise kjo hallke ka te beje me **kontrollin e te gjitha produkteve me baze shtazore, origjinen e tyre si dhe çertifikimin veterinar te produkteve te fresketa ne te gjitha pikat e tregëtimit brenda teritorit tone qe rrjedhin nga ligji dhe rregullorja perkatese e sherbimit veterinar.**

Objekt i punes sone ka te beje me nje aspekt shume te rendesishem te sigurise ushqimore qe eshte monitorimi i semundjeve zoonoze qe ne thelb do te thote parandalimi i semundjeve qe kalojne nga kafshet tek njeriu nepermjet konsumit te produkteve te tilla si mishi apo çdo nenprodukt tjeter i kafsheve.

Permbushja e ketij detyrimi ligjor ka te beje me menaxhimin dhe kontrollin e thertoreve.

Kontrolli i thertoreve eshte nje proces qe ka funksionuar mire ne pergjithesi deri ne tetor 2017 me perjashtim te faktit qe nuk po gjente zgjidhje problemi i pjisjes me çertifikata veterinare te levizjes se kafsheve para therjes . Pas dates 15 Tetor me nje urdher te MB( urdherit te ministrit te bujqesise **nr.451 date 24.10.2017 “Per koordinimin e punes ne kontrollin e therjes se kafsheve dhe tregëtimit te mishit te tyre”** si dhe shkreses nr.5302 prot. date 07.12.2017 nga Autoriteti Kombetare i Ushqimit Tirane), jane pezulluar te gjitha thertoret duke krijuar nje situatë konfuze dhe pasigurie ne fushen e sigurise ushqimore. Nga ana e AKU Tirane eshte hartuar nje çeklist per kushtet qe duhet te plotesojne thertoret dhe me pas do te kryhet rihapja e atyre subjekteve qe jane ne perputhje me ato kerkesa qe parashikon lista. Kjo ka bere qe te kemi dy probleme te rendesishme qe po pengojne punen tone:

- a. **Mos funksionimi i vjeljes se takses se therjes**
- b. **Tregëtimi i mishit ne menyre te paligjeshme ,i pa çertifikuar nga ana veterinare ne disa raste .**

Per te gjitha keto problematika ne i jemi drejtuar zyrtarisht AKU-se Beratme shkresen **nr.prot.2368 date 09.07.2018 “Per nje shqetesim ne lidhje me sigurine ushqimore”** dhe asnjehere nuk morem nje pergjigje duke i vene ne dijeni per situaten e krijuar ne kete drejtim. Ne zbatim te ligjit 87/2012” Per miratimin e aktit normativ nr 4 dt 16.08.2012, per percaktimin e rregullave per therjen e kafsheve dhe tregëtimit te mishit te tyre” ne i jemi drejtuar AKU Tirane me date 24.12.2018 per reflektim ndaj shkrese sone per AKU Berat si dhe problematika te tjera qe lidhen me sigurine ushqimore.

Situata aktuale ne kete fushe deri ne keto momente eshte e tille:

1. Aktualisht ne Bashkine tone nuk funksionon asnje thertore pas pezullimit deri ne plotesim te kushteve sipas standarteve qe kerkohen duke bere qe ky proces te kryhet ne thertore te tjera me te aferta si ne Berat, Lushnje apo Fier.
2. Nga ana jone kontrollohet çdo dite ne pikat e tregëtimit te mishit per dokumentacionin e nevojshem te produktit si çertifikatat veterinare dhe vulen e mishit dhe sipas rastit bashkepunohet me AKU Berat per disiplinimin e therjeve si nje detyrim ligjor per ne.
3. Aktualisht te gjitha pikat e tregëtimit te mishit ne territorin tone jane te rikonstruara sipas kerkesave te ligjit duke plotesuar kushtet sanitaro-veterinare (dhome frigoriferike, garderop, tualet etj). Ne kete drejtim duhet thene se eshte krijuar nje standart i mire ne drejtim te permbushjes se kushteve te sigurise ushqimore.
4. Gjithashtu nga ana jone po monitorohet edhe tregu qe menaxhohet nga ana e Bashkise per te gjitha llojet e produkteve qe tregtohen nga fermeret duke patur parasysh qe kryesisht diteve te diela ka nje fluks te madh te tregëtimit te produkteve te ndryshme duke rritur dhe riskun per konsumatorin. Ne kete aspekt vlen te theksohet se tregëtimi i peshkut le shume per te deshriuar ndonese nga ana jone serish eshte kerkuar ndihma AKU Berat. Duhet theksuar qe pas disiplinimit



te problemeve me mishin do te fokusohet puna ne disiplinimin e tregetimit, grumbullimit ,perpunimit te bulmetit (baxhot) te cilet do te kalojne ne siten e kontrollit ne te njejten intensitet dhe angazhim si edhe tregetimi i mishit. Po keshtu do te veprohet edhe per tregtimin dhe perpunimin e peshkut.

Ketyre problemeve te mesiperme se fundmi i shtohen edhe disa aspekte ligjore te amendimit te ligjit per sherbimin veterinar ku pritet te kete ristrukturim te ketij sherbimi me ngritjen e Agjensise se Sherbimit Veterinar per tre Qarqe si Berat, Korce dhe Elbasan duke u pare edhe disa nga kompetencat ligjore vendore per te shkuar drejt unifikimit te ketij sherbimi. Kjo pritet te ndodh ne vazhdim pasi ligji ende nuk eshte miratuar por keto jane te dhenat sipas projekt draftit te paraqitur nga Ministria e Bujqesise duke qene pjese e konsultimeve si grup interesi.

Nje problem shqetesues jane therjet nga persona te vecante neper fshatra jashte kontrollit veterinar ku nga ana jone jane evidentuar dhe u jane vene ne dijeni specialisteve te AKU por reagimi i tyre nuk eshte i kenaqshem.

Per periudhen Qershor-Gusht ne kemi hartuar nje plan masash te vecante ne kushtet e temperaturave te larta dhe ky plan konsiston ne kontrollin e vazhdueshem te tregut ne pergjithesi per kushtet higjeno-sanitare por edhe per zinxhirin ftohes te ruajtjes se produkteve ne pika te ndryshme te tregetimit. Ky sektor eshte kompletuar tashme edhe me specialistin e kontrollit ushqimor duke rritur efektivitetin e kontrollit qe ka te beje me termat e sigurise ushqimore te sistemit HACCAP.

Gjithashtu gjate muajve Tetor-Dhjetor u hartua nje plan veprimi ne bashkepunim me Drejtorine e Bujqesise Berat ne lidhje me kontrollin e levizjes se kafsheve te gjalla,matrikullimin e tyre situaten me tregjet e kafsheve te gjalla siç eshte tregu Lumas ku nga ana ime eshte paraqitur nje relacion spjegues per kete situat prane Kryetarit te Bashkise si dhe propozime konkrete se si mund te permiresohet kjo situat sipas protokollit zyrtare qe kerkohet.

Problem mbetet shtrirja e kontrollit edhe neper ish komunat ku duhet thene se duhet te jemi me prezent neper fshatra pasi edhe atje konsumohet mish dhe produkte te tjera ushqimore. Kjo kerkon nje mbeshtetje me mjete transporti apo karburant pasi ky eshte nje proces i perditshem kontrolli.

Ne kete kuader ne si drejtori jemi munduar te dalim nga stereotipi i vjeter i punes duke e shtrire sherbimin ne çdo fshat te bashkise se re per me teper qe ky sektore tashme eshte kompletuar me tre specialist.

Taksa e therjes eshte realizuar ne masen 65 mije leke, arsyeja e ketij mosrealizimi ka qene situata e krijuar me thertoret dhe pikat e tregetimit te mishit ku pas dates 15 Tetor 2017 ne nuk kemi vjele me taksen e therjes. Mendojme qe vitin 2019 kjo takse do te shkoj drejt zerimit.

Eshte ndjekur ne menyre te vazhdueshme por edhe sipas shqetesimeve qytetare problemi i qeneve pa pronare apo te rruges siç flitet ne gjuhen e perditeshme. Ka nje zgjidhje ligjore prej vitit 2013 ku Bashkia eshte autoriteti kompetent qe duhet te zgjidhe kete problem. Ky fenomen urban dhe jo vetem i yni mbart ne vetvete disa probleme dhe shqetesime si siguria e qytetareve, higjena dhe vete fakti qe keto kafshe jetojne ne meshiren e fatit, ne keqtrajtimin dhe dhunimin e perditeshem.

Qysh prej viti 2009 qe eshte bere nje eliminim fizik me arme i ketyre kafsheve nuk ka patur me nderhyrje nga ana jone, kjo edhe per faktin se zgjidhja ligjore eshte dhene ne vitin 2013 me ligjin e mesiperme pas nje debati me ambjentalistet per mbrojtjen e kafsheve.

Problemi eshte bere vertete shqetesues kohet e fundit ku kemi patur vazhdimisht ankesa nga qytetaret per agresivitet te ketyre kafsheve. Ne kete drejtim ne menjehere kemi verifikuar situaten dhe nepermjet struktures tone te sherbimit veterinar duke u bazuar ne vkm 230, kreu VI pika 5 e tij kemi vendosur per eliminimin e disa prej ketyre kafsheve sipas rasteve nepermjet eutanazise sipas percaktimit ligjor. Veshtiresia kryesore ne kete drejtim mbetet kapja fizike e ketyre kafsheve pasi ato jane gjithmone ne levizje dhe ne pika te ndryshme, per kete arsye ne menyre private ne kemi aktivizuar persona te ndryshem per ti kapur dhe jane eliminuar nepermjet eutanazise nga sherbimi veterinar. Te gjitha keto kosto kane qene zero per bashkine pasi ne i kemi perballuar privatisht. Raste te tilla kane qene rreth 12 kafshe qe i jane nenshtruar eliminimit nepermjet eutanazise.

